



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mësuesi për  
Arsimin Parashkollor” ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luigj Gurakuqi”  
Shkodër**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. Asoc. Dr Dilina Beshiri

2. Prof. Asoc. Dr Robert Gjedia

Tetor/2023

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Mësuesisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.150, datë 18.04.1957 “Për hapjen e “Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës”
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM nr.124, datë 28.05.1991 “Për krijimin e Universitetit Luigj Gurakuqi” Shkodër”
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë-Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipja
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/5 PAK
18	Numri i studentëve:	51 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në dy elemente kryesorë, si: Shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (në vijim USH) dhe së dyti sipas veprimtarive të realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe USH. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë me emërtesë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor. Ky program i ka filluar në vitin akademik 1996-1997, sipas VKM nr.332, datë 13.05.1996 për hapjen e Programit “Mësuesi për Ciklin Parashkollor” me kohëzgjatje 3-vjeçare.

Programi ofrohet prej Departamentit të Mësuesisë (DM) pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit (FSHE), fakultet i hapur dhe i riorganizuar sipas Vendimit nr.117, datë 31.10.2000 të Senatit të USH-së, ku Fakulteti i Ciklit të Ulët shndërrohet në Fakultet i Shkencave të Edukimit, emër që mban dhe sot.

Aktualisht, programi Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program synon të formojë mësues për arsimin parashkollor. Ai përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Në përfundim të ciklit të studimit tre vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare Diplomë “Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në tre vitet e fundit, është:

- Për vitin akademik 2022-2023 është 28 studentë
- Për vitin akademik 2021-2022 është 13 studentë
- Për vitin akademik 2020-2021 është 10 studentë

Gjithsej 51 studentë. Të diplomuar 10 studentë

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

### *Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm*

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, nga ana e programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga Prof.Asoc.Dr Dilina Beshiri dhe Prof.Asoc.Dr. Robert Gjedia dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, znj. Anilda Beqiraj. Vizitat u realizuan në datat 12 dhe 13 Korrik 2023. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije nga ekspertja e ASACL.


*Dokumentacioni ligjor mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor në FSHE, të USH-së, është:*

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 167, datë 28.05.1991 “Për Vendimin e hapjes së Universitetit të Shkodrës ”Luigj Gurakuqi”;
- VKM nr.332, datë 13.05.1996 për hapjen e Programit “Mësuesi për Ciklin Parashkollor” me kohëzgjatje 3-vjeçare në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës.
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”.
- Statutin e UE dhe Rregulloret në USH.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

### **Aktivitetet kryesore të realizuara**

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambjentet e brendshme të USH dhe FSHE-së.

**Analiza e të dhënave parësore** është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor (Pril 2023), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.



**Analiza e të dhënave dytësore** u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit që mbulon programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë;
- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë ;
- Vizitë në Sekretarinë mësimore;
- Takim me Përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore;
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe i bibliotekës
- Takim përfundimtar me Përgjegjësën e Departamentit;

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizmi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe:

**Vëzhgimi i mjediseve mësimore** në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të pikturës, të muzikës, të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së FSHE-së dhe të USH-së.

Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.

**GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:**

**GVJ në Fusha IV - Standarti I. kriteri I, fq. 35-36**

GVJ sugjeron që personeli akademik me kohë të plotë, për këtë program studimi, të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Komente nga GVB:** Bazuar në RVB e programit të studimit si dhe gjatë vizitës në institucion, për tre vitet e fundit akademike (2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022), konstatohet që, personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij program studimi, respekton kriteret ligjore në fuqi, si dhe ofron ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies.

Bazuar në RVB dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit BA Arsim Parashkollor, bazuar në tabelat 2 të Evidencë 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada)<sup>1</sup> është:

Tituj/grada	2022 -2023		2021 -2022		2020 - 2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-	1	-	2	-
Prof.As.Dr	-	-	-	-	-	-
Dr/PhD	5	1	4	1	4	1
Dr proces	1	-	-	-	-	-
Msc	1	5	3	4	3	3
Në total	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>4</b>

Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësite kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu I, pika 3.3.c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”, evidentohet se numri i stafit akademik të brendshëm të angazhuar (PAK) ka ardhë në rënie dhe ai me atë me kohë të pjesshme (PAE) në rritje, gjë e cila sjell prishje të raportit PAK/PAE sipas udhëzimit të sipërcituar.

<sup>1</sup> Evidencë 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada). Evidencë 1.15 Ngarkesa totale e PAE-PAK 2022-2023.

Rezulton një mospërputhje për deklarinimin e raportin PAK/PAE ndërmjet shkresës dërguar nga DM drejtuar grupit të vlerësimit të brendshëm dhe Evidencës 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada).


Për vitin akademik 2022-2023, rezulton se raporti PAK dhe PAE është 8-6 (67.1%- 42,9%) , si rrjedhojë,

Rekomandojmë që personeli akademik me kohë të plotë, për këtë program studimi, të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Komentet e institucionit:** sqarojmë në evidencën e sipërcituar, grupi i RVB-së së këtij programi ka përfshirë vetëm stafin e brendshëm dhe të jashtëm të Departamentit të Mësuesisë dhe nuk ka përfshirë stafin e brendshëm. Theksojmë se një pjesë e konsiderueshme e lëndëve të këtij programi mbulohen nga programe të tjera si psh. Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Matematikës.

**GVJ** i vlerëson informacionin e paraqitur nga institucioni si dhe verifikon anomalinë teknike pasqyruar nga GVB, siç kontastaton edhe vetë institucioni, e si rrjedhojë reflekton ndryshimet si vijon:

Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu I, pika 3.3.c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”, si dhe në shkresën e dërguar Përgjegjësi i Departamentit konstatohet se për vitin akademik 2022-2023 raporti PAK/PAE, i Departamentit të Mësuesisë është 73.7% / 26.3%.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

### OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga USH evidentohet se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është në përputhje dhe përshtatje me interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe me qëllimet kombëtare. Programi i studimit synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në funksion të komunitetit, shtetit, etj, duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve në nivel lokal, rajonal e më gjerë, mbështetur në “Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë<sup>1</sup> dhe udhëzimet e ardhura nga MAS. Ky program studimi synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare<sup>2</sup> dhe përpiqet të pasurojë dhe të rrisë këto vlera si dhe synimet akademike të studentit nëpërmjet aktiviteteve që i promovojnë ato.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Konstatohet se nga shqyrtimi i Statutit të institucionit si dhe i planit Strategjik të FSHE-së, Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është në përputhje me qëllimet strategjike të institucionit dhe me misionin e institucionit, sepse ky program studimi synon një edukim cilësor dhe të përshtatshëm të brezit të ri, si dhe ka për detyrë të krijojë aftësi bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesionale dhe specialitetesh, sipas fushave që mbulon<sup>3</sup>. Nga shqyrtimi i Rregullores së FSHE-së, Neni 5 i saj “Misioni i FSHE-së evidentohet se programi është në të njëjtën linjë me misionin e USH, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushën e mësimdhënies në arsimin parashkollor.<sup>4</sup></p>

<sup>1</sup> Evidenca 1.1. Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” dhe Evidenca I. Statuti i USH.

<sup>2</sup> Evidenca 1.1. Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

<sup>3</sup> Evidenca I. Statuti i USH; Evidenca 1. Vendim i Hapjes së Programit të Studimit

<sup>4</sup> Evidencat 1.5 dhe 1.6. ( Rregullore e FSHE-së, Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”



<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>Konstatohet se Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është në përputhje me qëllimet strategjike 2019-2022 dhe 2022-2026 të USH dhe statutit të saj.<sup>5</sup> Evidentojmë se Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të USH<sup>6</sup> dhe ky program studimi përgatit specialistë në fushën e arsimit parashkollor, duke kontribuar në përgatitjen teoriko-praktike përmes lëndëve të përgjithshme dhe specifike, praktikave pasive e aktive në kopshte të këtyre mësuesve të ardhshëm<sup>7</sup>.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita dhe takimet në IAL evidentojmë se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen gjithnjë e në përmirësim që prej vitit akademik 1996-1997, ku me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 332, datë 13.05.1996, pranë Fakultetit u hap dega “Mësues për Arsimin Parashkollor” për përgatitjen e edukatorëve të kopshteve me afat studimi 3-vjeçar<sup>8</sup>. Departamenti i Mësuesisë që mbulon këtë program studimit ofron programe studimi në dy nivele (bachelor e master) në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit, në përputhje me Statutin e USH-së<sup>9</sup>. Konstatohet se Departamenti i Mësuesisë përmbush kriteret sasiore dhe cilësore të stafit akademik, kualifikimet e duhura për zbatimin e efektshëm të programit. Departamenti përbëhet nga 1 Prof.dr, 5 Dr, 1 Dr. proces, 1 Msc. Në këtë program studimi, japin kontributin e tyre pedagogë nga fakultetet e tjera të USH-së, ku mund të vërehet se pjesa më e madhe e tyre kanë gradat: Prof.Dr, Prof.as.Dr dhe titullin Dr. Vihet re qartë se stafi akademik me kohë të plotë dhe stafi akademik me kohë të pjesshme ka përgatitje të përshtatshme akademike e shkencore, në përputhje me kërkesat e këtij programi studimi, si dhe ruhet dhe respektohet raporti i stafit akademik me kohë të plotë dhe stafi akademik me kohë të pjesshme<sup>10</sup>.</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p>	<p>Rezulton se Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ofrohet nga Departamenti i Mësuesisë dhe e bën plotësisht të përputhshme atë me fushën akademike të studimit dhe fushën e edukimit e të mësuesisë. Stafi i njësisë kryesore dhe asaj bazë lidhet thelbësisht me programin e studimit BA në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, sepse fusha e përgjithshme, mësuesia dhe fusha specifike, mësuesi për arsimin parashkollor është në përputhje me fushën</p>

<sup>5</sup> Evidenca IV. Strategjia e mësimdhënies 2017; Evidenca I. Statuti i USH.

<sup>6</sup> Evidenca VIII dhe Evidenca IX. (Strategjia e zhvillimit 2022 dhe 2017)

<sup>7</sup> Evidenca 1.5, 1.6, 1.7. (Rregullore e FSHE-së, Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Strategjia e programit të studimit- Ba. A. Parashkollor)

<sup>8</sup> Evidenca A. Vendim i Hapjes së Programit të Studimit

<sup>9</sup> Evidencat 1.18. Raport PAE/PAK

<sup>10</sup> Evidenca 1.15. Ngarkesa totale e personelit PAE/PAK 2022-2023

klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, pjesë e të cilit është dhe Departamenti i Mësuesisë <sup>11</sup> .		
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit I.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi është në përputhje me qëllimet dhe interesat kombëtare. Ky program ka 27 vite që zbatohet nga USH dhe kjo IAL ka kapacitete të kualifikura dhe të mjaftueshme për zhvillimin e efektshëm të tij, ndaj GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatojmë se Departamenti i Mësuesisë ka marrëdhënie bashkëpunimi brenda dhe jashtë Fakultetit të Shkencave të Edukimit me 13 departamente që lehtësojnë zbatimin e prigramit, përkatësisht me Departamentin e Gjuhës, të Letërsisë, të Historisë, të Gjeografisë, të Fizikës, të Kimisë, të Biologjisë, të Matematikës, të Psikologjisë dhe Punës Sociale, të Edukimit Fizik dhe Sporteve, të Gjuhës Angleze, të Romanistikës, të Gjermanistikës <sup>12</sup> . Evidentohet se Departamenti realizon në mënyrë të përvitshme analizën e punës shkencore, mësimore dhe artistike të departamentit duke vënë në dukje pikat e forta, të dobëta dhe mundësitë për përmirësim <sup>13</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me	Konstatojmë se Departamenti i Mësuesisë ka marrëdhënie bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit me institucione, si: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër dhe DRAP Lezhë, ku identifikohen shumë shkolla që shërbejnë për zhvillimin e praktikave profesionale, me universitetin e Podgoricës në Malin e Zi, me Kryqin

<sup>11</sup> Evidenca 1.1, 1.5, 1.25.( Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Rregullore e FSHE-së, Vendim Rektorati për hapjen e LTEV)

<sup>12</sup> Evidenca 1.1, 1.13, 1.21, 1.19, 1.14, 1.16.( Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Cilësia e stafit (Tab. 6), Ngarkesa e stafit nga departamentet e tjera (2019-2022), Ngarkesa e stafit 2020-2023 (Tab.4), Kualifikimi i stafit (Tab.7), Plani mësimor lidhur me personelin (Tab.12)

<sup>13</sup> Evidenca 1.27.( Analiza e punës mësimore-shkencore, Departamenti i Mësuesisë)

<p>institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>e Kuq Shqiptar<sup>14</sup>. Një përvojë e mirë evidentohet ajo e projektit IDEA (Erasmus +), i cili ka sjellë ndikime në përmirësimin e cilësisë së punës dhe veprimtarisë së studentëve me aftësi ndryshe në USH<sup>15</sup> Po ashtu evidentohen dhe veprimtari të tjera me departamentin e Infermierisë, me departamentin e Psikologjisë dhe Punës sociale<sup>16</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Evidentohet se IAL ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit me ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, duke bashkëpunuar me punëdhënësit në lidhje me përfundimin dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore. Studentët gjatë kryerjes së praktikave profesionale mbikëqyren nga stafi akademik i ngarkuar dhe nga stafet e kopshtet e Shkodër, “Ismet Sali Bruçaj” dhe “Bep Tusha” Shkodër, të përzgjedhura nga marrëveshjet e bashkëpunimit<sup>17</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Theksojmë se Marrëveshjet e Bashkëpunimit me DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër kanë mundësuar një zbatim të efektshëm të praktikave profesionale pasive dhe aktive në kopshtet e qytetit të Shkodrës. Nga bisedat me stafin evidentohet se praktikant ndiqen nga pedagogu mentor, në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe më pas realizon edhe një analizë lidhur me këto praktika<sup>18</sup>.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit I.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se Departamenti që mbulon programin ka krijuar një kulturë bashkëpunimi me institucione dhe projekte që mbështesin formimin akademik dhe praktik të studentëve, ndaj GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<sup>14</sup> Evidencat 1.12 dhe Evidenca XXXVI (Nr. i personelit akademik (tituj/grada) (Tab. 1 & 2); marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti).

<sup>15</sup> Evidenca 1.31. Projekti IDEA

<sup>16</sup> Evidencat 1.27, 1.42. (Analiza e punës mësimore-shkencore, Departamenti i Mësuesisë, Bashkëpunimet kombëtare e ndërkombëtare të USH-së (Tab.20)

<sup>17</sup> Evidenca 1.3. (Marrëveshja me DRAP Lezhë)

<sup>18</sup> Evidencat 1.3, 1.40, 1.41. (Marrëveshja me DRAP Lezhë; Analizë praktike profesionale, Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për program studimi (Tab. 5)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Rezulton se Departamenti i Mësuesisë ofron dy programe të ciklit të parë të studimit, Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor dhe Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, si dhe një cikël të dytë të studimeve, Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor. Programi i studimit Ba në Mësuesi për Arsimin Parashkollor ka 180 kredite (ECTS), bazuar në bazën ligjore përkatëse. Nga analiza e kurrikulës së këtij programi krahasuar me programe të ngjashme në universitetet shqiptare ku kemi qenë vlerësues të jashtëm vihet re se lëndët në këtë program studimi kanë ngjashmëri edhe me programet e universiteteve më të mira ze në vend në rajon e më gjerë, kjo dhe e në shqyrtimin e lëndëve që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70% <sup>19</sup> . Nga analiza e kurrikulës së programit të studimit Bachelor vihet re se ajo ka planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për kreditet e lëndëve apo moduleve, ngarkesën javore e ngarkesën e përgjithshme mësimore në auditor dhe detyrimet në përfundim të lëndës/modulit (Provim/Firmë) <sup>20</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të	Nga analiza e kurrikulës së Programi të Studimit, si dhe në takimet me stafin dhe studentët, konstatojmë se ky program synon të përgatisë specialistë të arsimit parashkollor, me kompetencat e domosdoshme për zhvillimin e një procesi mësimor ku në fokus është të nxënë, modelet e ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënës, si dhe kërkimi didaktik dhe pedagogjik në edukim <sup>21</sup> . Nga analiza e gruplëndëve bazë, formuese dhe ato të specialitetit vihet re se ky program i jep rëndësi zhvillimit të

<sup>19</sup> Evidencat 1.1, 2.1, 1.6, 1.27. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për arsimin parashkollor”, Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (a-f) (tab. 9); Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për arsimin parashkollor”; Analiza e punës mësimore-shkencore, Departamenti i Mësuesisë)

<sup>20</sup> Evidenca 2.2. Procedurat për zhvillimin e praktikës profesionale

<sup>21</sup> Evidencat 1.1 dhe 1.6. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për arsimin parashkollor”, Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për arsimin parashkollor”)

<p>kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>aftësive praktike, të cilat janë të rëndësishme për formimin e gjithanshëm të mësuesve. Lëndë të tjera, si: Sociologji, Psikologji Edukimi, Teknologji edukimi, Shprehi në komunikim etj., lehtësojnë e mundësojnë më shumë zhvillimin e aftësive personale e ndërpersonale dhe përballjen me situata të reja në punë e jashtë saj, ndërsa lëndët, si: Matematika Elementare, Gjuhë Shqipe, Psikologji Zhvillimore dhe Edukim Gjithëpërfshirës, Pedagogji Parashkollore, Artet dhe didaktikat etj, mundësojnë një formim të plotë profesional, aftësi dhe kompetenca në përgatitjen e tyre si mësime të mësuara<sup>22</sup>. Theksohet në dokumentacionin kurrikular të programit se ai synon të përgatisë mësues të aftë, të cilët mund të angazhohen apo punësohen sipas kërkesave të tregut të punës në kopshte publike dhe jo publike; në OJF, të cilat ofrojnë shërbime në edukim; në institucione qendrore dhe lokale të edukimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Evidentohet se ky program studimi nëpërmjet kurrikulës së tij është në përputhje me kërkesa ligjore të ndërtimit të planit mësimor, sepse i ka të grupuara lëndët sipas tipeve të veprimtarive në disiplina të formimit të përgjithshëm (simboli A) me 27 kredite, të cilat u ofrojnë mësuesve formim të gjithanshëm; në disiplina të formimit karakterizues (simboli B) me 103 kredite, të cilat ndikojnë në formimin metodologjik e didaktik të mësuesit; në disiplinat e ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese (simboli C) me 18 kredite; në disiplinat me zgjedhje (simboli D) 26 kredite e njohuri të tjera formuese (simboli E) me 6 kredite. Cikli i parë i studimeve mbyllet me provim formimi ose tezë diplome<sup>23</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit kurrikular të Programit të studimit evidentohet se ai ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale, e cila realizohet në vitin e tretë me 12 ECTS. Studentët dërgohen pranë institucioneve arsimore, të përzgjedhura dhe të përcaktuara nga marrëveshjet e nënshkruara mes institucionit USH dhe ZVAP, Bashkisë Shkodër. Gjithashtu evidentohet se Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për detyrime përmblylëse me provimin përfundimtar me 6 ETC<sup>24</sup> Në evidencën 1.18 sqarohet se Praktika realizohet në 2 mënyra: Praktika pasive me 6 kredite dhe praktika aktive me 6 kredite. Praktika pasive zhvillohet gjatë semestrit të parë të vitit të tretë një ditë në javë, ndërsa praktika aktive zhvillohet katër javët e para të semestrit të dytë në një ditë të javës, katër orë në ditë. Po ashtu evidentohet në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimin me stafin e Departamentit të Mësuesisë se ai</p>

<sup>22</sup> Evidenca 1.40, 2.2.( Analizë praktike profesionale; Procedurat për zhvillimin e praktikës profesionale)

<sup>23</sup> Evidenca 1.1, Evidenca 1.6. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Rregullore e programit të Studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”;

<sup>24</sup> Evidenca II, Evidenca 1.6.(Rregullore e studimeve në USH; Rregullore e programit të Studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”;

	zhvillon mbledhje të vecanë dhe harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga analiza e dokumentacioni të kurrikulës së programit të studimit evidentohet ai bazohet tërësisht në vendimet dhe udhëzimet e ardhura nga MAS për institucionet e Arsimit të Lartë. Në fund të çdo viti akademik njësia bazë miraton kuotat për studentët brenda vendit, program i dytë studimi, transferim studimesh, shtetas të huaj, me statusin e jetimit, persona me AK si dhe romë e egjiptianë, kategoritë e veçanta të studentëve (me status jetim, me ndihmë ekonomike, me prindër invalidë, mesatare 9-10), kuota që dërgohen për miratim në Senat nga Dekanati e më pas bëhet shpallja në faqen zyrtare të USH-së, ndërsa forma e studimit është me kohë të plotë <sup>25</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga analiza e planit mësimor të programit dhe nga diskutimi me stafin e departamentit konstatohet se lëndët e këtij programi studimi kanë ngjashmëri edhe me programet e universiteteve më të mira në vend që ofrojnë këtë program, por dhe me ato në rajon ( psh në Malin e Zi) dhe më gjerë. Po ashtu evidentohet se dokumentacioni kurrikular respekton Ligjin e Arsimit të Lartë, neni 86 (Programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70%) <sup>26</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe nga verifikimi me takimin me përgjegjësen e departamentit konstatohet se programi i studimit është i ndërtuar në përputhje me kriteret e kërkuara dhe sipas bazës ligjore përkatëse. Bazuar në vendimin Nr. 310 dt11.05.2022” Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, është bërë edhe kodifikimi i programeve të studimit. Nga ana tjetër programi i studimit gjykojmë se është në përputhje të plotë të fushës së edukimit sepse ai është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamentit të Mësuesisë që e zbaton dhe ai përgatit mësues të ardhshëm në arsimin parashkollor <sup>27</sup> .
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të	Konstatohet se ky program studimi ofrohet vetëm nga Departamenti i Mësuesisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit dhe nuk është program i përbashkët studimi.

<sup>25</sup> Evidenca 1.5, 1.6. (Rregullore e FSHE-së; Rregullore e programit të Studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”;

<sup>26</sup> Evidenca 1.1, Evidenca 2.4. ( Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Programe të ngjashme me universitetet e tjera)

<sup>27</sup> Evidenca 1.1, Evidenca 2.5, Evidenca 2.2.( Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Procedurat për zhvillimin e praktikës profesionale; Model Syllabus0

lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.									
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit II.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit përmbush kriteret ligjore për ndërtimin dhe zbatimin e kurrikulës së tij, ofron formim akademik dhe praktik të domosdoshëm, ndërsa plani mësimor dhe përmbajtja e tij, me anë të lëndëve bazë, të formimit profesional, atij me zgjedhje, apo detyrime përmbyllëse etj, respekton kriteret ligjore, si dhe ai është në përshtatje dhe me ngjashmëri me programe të këtij lloji që ofrojnë universitete të tjera në vend dhe jashtë tij. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				X
		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			X						

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, nga evidencat përkatëse që e shoqërojnë, por dhe nga takimet me dekanin, me Përgjegjës të departamentit dhe me stafin që mbulon programin rezultojnë se njësia bazë dhe kryesore funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe me Statutin e institucionit. FSHE është i përbërë nga 4 departamente: Departamenti i Mësuesisë, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale, Departamenti i Arteve dhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve <sup>28</sup> . Gjithashtu konstatojmë se Programi i studimit ndjek dhe zbaton të gjitha udhëzimet ligjore të ardhura për t'u zbatuar, në përputhje me të gjitha kriteret (Ligjit i Arsimit të Lartë 80 / 2015) dhe aktet nënligjore lidhur me organizimin e strukturën akademike të ofruara për zbatim si dhe Statutit të Universitetit <sup>29</sup> . Nga ana tjetër evidentojmë se Departamenti i Mësuesisë, si njësi bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike në mbështetje të misionit të tij <sup>30</sup> . Po ashtu Departamenti për zgjedh stafin akademik në varësi të

<sup>28</sup> Evidenca 1. Evidenca 1.5.( Statuti i USH; Model sylabusi)

<sup>29</sup> Evidencat 1.15, 1.9, 2.8, 2.9.1.( Ngarkesa totale e personelit PAE/PAK 2022-2023; Plani strategjik i FSHE; Listëprezenca e stafit (model); Kërkimi shkencor i stafit.

<sup>30</sup> Evidenca 2.9.1, 2.10.( Kërkimi shkencor i stafit; Rinovim kontrate pas marrjes së gradës Dr.)

	<p>nevojave të departamentit apo programit të studimit dhe konform akteve ligjore dhe nënligjore<sup>31</sup>. Konstatohet se ka plan dhe zbatim të zhvillimit profesional dhe të kualifikimit të stafit, i cili dhe monitorohet nëpërmjet veprimtarisë shkencore që zhvillohet si dhe marrjes së titujve e gradave<sup>32</sup>. Theksojmë se si akreditim i parë identifikohet një përpjekje e madhe dhe motivim për ta shndërruar vetëvlerësimin një kulturë pune të përvitshme. Kjo, sepse Departamenti i Mësuesisë kishte përcaktuar grupet e punës për të bërë realizimin e vlerësimit të brendshëm, përgatitjen e raporteve të vlerësimit sipas grupeve përkatëse, përgatitjen e dokumentacionit përkatës në një bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Fakultetit<sup>33</sup>. Bazuar në rekomandimet e Akreditimit të fundit, institucional konstatohet se USH ka përfunduar dhe hartimin e paketës së instrumenteve matës të cilësisë në USH dhe Manualin e Cilësisë<sup>34</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Konstatohet nga analiza e kurrikulës, nga takimi me stafin, nga takimi me studentët se praktika profesionale e programit të studimit zhvillohet gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë, gjatë 15 javëve, me nga një ditë në javë, në kopshtet e qytetit të Shkodrës. Praktika mentorohet nga një pedagoge, e cila në përfundim të lëndës dorëzon analizën e saj<sup>35</sup>. Nga takimet me stafin mbështetës dhe me studentët rezulton se studentët mbështeten nga një personel ndihmës gjatë procesit mësimor dhe veprimtarive që realizohen në këtë program studimi<sup>36</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit</p>	<p>Nga takimi me stafin që mbulon programin konstatohet se rolin e koordinatorit të këtij programi studimi, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit, e realizon përgjegjësjë e departamentit me të gjitha përgjegjësitë përkatëse. Ajo përcakton pedagogët përgjegjës (tutorët) sipas kurseve, të cilët janë pedagogë që japin mësim pranë këtij programi në një vit akademik<sup>37</sup></p>

<sup>31</sup> Evidenca 2.10. Rinovim kontrate pas marrjes së gradës Dr

<sup>32</sup> Evidenca 2.6. Kodifikimi

<sup>33</sup> Evidenca B. Evidenca 2.11. (Vendim i formimit të GVB-së, Vendim Dekanati për Ristrukturimin e NJSBC-së në FSHE)

<sup>34</sup> Evidenca X, Evidenca XVI. (Manuali i cilësisë; Paketa e instrumenteve matës të cilësisë në USH)

<sup>35</sup> Evidenca 1.11, Evidenca 1.15. (CV - staf i jashtëm; Ngarkesa totale e personelit PAE/PAK 2022-2023)

<sup>36</sup> Evidenca 2.11. (Vendim Dekanati për Ristrukturimin e NJSBC-së në FSHE)

<sup>37</sup> Evidenca 1.1, Evidenca 2.13 (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Vendim për miratimin e tutorëve & Listat e tutorëve)



dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.									
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se IAL ka njësi kryesore dhe bazë funksionale konform akteve ligjore dhe nënligjore që mbulojnë këtë program studimi, zhvillon dhe realizon praktikë profesionale të efektshme për studentët në vitin e dytë të studimit, bën përpjekje pozitive për instalimin e kulturës së vetëvlerësimit, si dhe ka përgjegjësi dhe detyra të ndara qartë dhe të zbatueshme në departament për lehtësimin e studentëve. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						
<b>Standardi II.3</b>									
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>									
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>								
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga takimi me stafin dhe me Përgjegjësen e Departamentit konstatohet se njësia bazë ka një bazë të pasur të dhënash të ruajtura dhe të arkivuara lidhur me programin e studimit, të cilat disponohen në formë elektronike dhe në formë të printuar (në dosje të veçanta) <sup>38</sup> . Njësia bazë ka arkivën e saj të Departamentit të Mësuesisë, por dhe të Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Konstatohet se programi i studimit është hartuar dhe zbatohet konform udhëzimeve të MAS. Plani mësimor përmban komponentë të formimit të përgjithshëm, të formimit profesional, të specialitetit, të formimit ndërdisiplinor të studentit dhe të detyrimeve përmblylëse <sup>39</sup> .								
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, përkatësisht të planit mësimor dhe të programeve lëndore evidentohen informacionet e nevojshme për kreditet e lëndëve apo moduleve, ngarkesën javore e ngarkesën e përgjithshme mësimore në auditor dhe detyrimet në përfundim të lëndës/modulit (Provim/Firmë). Programi i studimit Bachelor ofron në mënyrë të detajuar lëndët dhe shtrirjen përgjatë vitit akademik, si dhe paraqitet për çdo lëndë kohështrirje vjetore apo								

<sup>38</sup> Evidencat 1.1, 1.5, 1.6, 1.7, 1.2,2.7, I. (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Rregullore e FSHE-së dhe ajo e Programit; Strategjia e programit të studimit- Ba. A. Parashkollor; Lista e marrëveshjeve institucionale; Numri i programeve të studimit (Tab. 3), Statuti i USH;)

<sup>39</sup> Evidencat 1.1, 1.6, 1.19, 1.15, 1.21, 2.14. (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Rregullorja e programit; Ngarkesa e stafit 2020-2023 (Tab.4); Ngarkesa totale e personelit PAE/PAK 2022-2023; Ngarkesa e stafit nga departamentet e tjera (2019-2022); Ngarkesa totale në auditor e studentëve (2019-2022) (Tab 13).

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	semestrare, duke përcaktuar javët mësimore, orët e leksioneve, orët e seminareve, praktikave apo laboratorëve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse për secilën lëndë/modul <sup>40</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, nga takimi me stafin e tij dhe studentët vihet re se studentët kanë mundësi që të njihen me përmbajtjen e tij në dokumentet e paraqitura online në faqen e internetit të IAL, por dhe dhe në Rregulloren e së USH-së, ditën e parë të shkollës, ku studentët njihen me strukturën, kurrikulën, detyrimet. Po ashtu secili pedagog bën njohjen me detyrimet dhe kërkesat që lidhen me lëndën specifike në fillim të lëndës, sipas semestrave <sup>41</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Siç është cituar më lart konstatojmë se dokumentacioni i kurrikulës së programit paraqet në mënyrë të detajuar lëndët, shtrirjen përgjatë vitit akademik, orët e seminareve, praktikave apo laboratorëve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse. Programet lëndore paraqesin gjithashtu një përmbajtje të lëndës, rezultatet e të nxëniet, konceptet kyç, temat, format e kontrollit dhe literaturën <sup>42</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga takimi me stafin që mbulon programin konstatojmë se ky program studimi ka qëndrueshmëri sepse përvoja e tij është mbi 27 vite, por herë pas here ai është pasuruar ose përmirësuar qoftë në përmbajtjen, por dhe në aspektin metodologjik. Programi ka krijuar lidhje dhe me standardet zyrtare të arsimit parashkollor për grupmoshat 4-6 vjeç, por ndjehet nevoja e përfshirjes së stafit në reformat dhe ndryshimet kurikulare që zbaton MAS në arsimin parashkollor <sup>43</sup> .
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit II.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit është hartuar dhe zbatohet konform kriterëve ligjore, njësia bazë ka arkivë për dokumentacionin e programit, studentët informohen online dhe në auditor lidhur me përmbajtjen e programit, si dhe programi dëshmon qëndrueshmëri dhe

<sup>40</sup> Evidencat 1.1, 1.5, 1.9, 2.10. (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Rregullore e FSHE-së; Plani strategjik i FSHE; Rinovim kontrate pas marrjes së gradës Dr.)

<sup>41</sup> Evidenca 2.4, II, 2.27, 2.15, 5.3, 4.11. (Programe të ngjashme me universitetet e tjera; Rregullore e Studimeve në USH, Vendim - Miratim kuota e kritere; Lista e studentëve fitues AP; Ekuivalentim studimesh të studentëve; Cilësia në hyrje e studentëve (Tab. 21)

<sup>42</sup> Evidencat 1.1, 2.16, 2.5. (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Syllabuse; Model Syllabus)

<sup>43</sup> Evidenca 2.17. Vendim - Miratim syllabuse.

	përmirësime të nevojshme gjatë zbatimit të tij. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, nga takimi me stafin e tij dhe studentët konstatohet se Programi i studimit u ofron studentëve orë të nevojshme e të mjaftueshme teorike e praktike për aftësimin e zhvillimin e tyre profesional për punësimin e tyre të ardhshëm. Programi i studimit bazohet në një kurrikul me ngjashmëri me programet bashkëkohore të së njëjtës fushë që ofrohen nga universitete të tjera në vend dhe në rajon. Konstatohet se programi ofron jo vetëm orë në auditor, por edhe orë në laboratore e në terren përmes praktikës aktive e pasive në shkolla Konkretisht programi përmban 855-orë leksione; 1055-orë seminare; 240-orë praktike në shkollë; laborator 60-orë mësimore, diploma/provim formimi 150 orë, me një total prej 2360 orë në auditor gjatë tre viteve akademike <sup>44</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Siç është cituar më lart konstatohet se dokumentacioni i kurrikulës së programit paraqet në mënyrë të detajuar lëndët, shtrirjen përgjatë vitit akademik, orët e seminareve, praktikave apo laboratoreve, tipologjinë e lëndës, pedagogët e përfshirë në këtë program studimi si dhe kreditet përkatëse. Programet lëndore paraqesin gjithashtu një përmbajtje të lëndës, rezultatet e të të nxënit, konceptet kyç, temat, format e kontrollit dhe literaturën <sup>45</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me	Nga analiza e kurrikulës së programit, nga takimi me stafin dhe me studentët evidentohet se ky program ka 180 kredite të ndara në 3 vite e sipas lëndëve e moduleve, në përputhje me profilin e programit të studimit. Lëndët në programe kanë ngjashmëri edhe me programet e universiteteve prestigjioze në vend në rajon e më gjerë, kjo bazuar edhe

<sup>44</sup>Evidencat 1.1, 2.1, 2.19, 2.14. (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) (Tab. 9); Plani mësimor (Tab. 10); Ngarkesa totale në auditor e studentëve (2019-2022) (Tab 13).

<sup>45</sup>Evidencat 1.1, 2.16. (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Syllabuse ;)

programe të ngjashme ndërkombëtare.	në Ligjin e Arsimit të Lartë, neni 86. Gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë realizohet praktika në kopshtet e qytetit të Shkodrës 1 ditë/ javë. Raporti teori-praktikë është i arsyeshëm dhe i pranueshëm për formimin e domosdoshëm të studentëve <sup>46</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit rezultojnë se ai është ndërtuar në përputhje me kriteret ligjore. Konkretisht ai përmban: Disiplina të formimit të përgjithshëm (simboli A-27 ECTS); Të formimit karakterizues (simboli B - 103 ECTS); Të ngjashme ose/dhe integruese me disipinat karakterizuese, (simboli C-18 ECTS ); Disipinat me zgjedhje ( simbol D -26 ECTS); Njohuri të tjera formuese (simboli E -6 ECTS). Nga takimi me studentët ata shprehin se ka patur oferta nga universitete të ndryshme, mbështetur nga Programi Erasmus + për vijimin e studimeve, por që nuk ishte zhvilluar ndonjë veprimtari mobiliteti <sup>47</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga takimi me stafin e programit rezultojnë se bëhen përpjekje për përditësimin e përmbajtjes së kurrikulës në përputhje me ndryshimet dhe risitë sidomos ato teknologjike, shkencore e artistike, të cilat diskutohen dhe miratohen në takimet departamentale <sup>48</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga shqyrtimi i kurrikulës së programit identifikohet se ai ofron njohuri, aftësi e kompetenca për t'i bërë ata mësues të aftë profesionalisht dhe nxënës gjatë gjithë jetës, si dhe i referohen edhe Kompetencave të Arsimit Parashkollor sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parashkollor <sup>49</sup> .
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me	Nga analiza e kurrikulës së këtij programi dhe e përshtatshmërisë së tij me aktet ligjore, si dhe nga takimi me stafin konstatohet se ky program mundëson për studentët punësim të menjëhershëm në tregun e punës si mësues/e kopshti/arsimi parashkollor, por duke parë lëndët e

<sup>46</sup>Evidencat 1.1, 1.6, 1.28, 1.40, 2.4. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Rregullore e Departamentit Mësuesi; Analizë praktike profesionale; Programe të ngjashme me universitetet e tjera;)

<sup>47</sup>Evidencat 1.1, 2.1, 2.20, II, 5.3. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) (Tab. 9); Mobiliteti i studentëve; Rregullore e Studimeve në USH; Ekuivalentim studimesh të studentëve)

<sup>48</sup> Evidenca 2.16, 2.17.(Syllabuse; Miratim syllabuse)

<sup>49</sup> Evidencat 1.1, 2.16, 2.21. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Syllabuse; Korniza kurrikulare - Arsim Parashkollor

prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.	shumëllojshme që zhvillohen, gjykojmë se ky program u mundëson dhe studime në ciklin e dytë në fushën e edukimit <sup>50</sup> .		
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-7 të standardit II.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vëren se programi i studimit është hartuar dhe zbatohet konform kriterëve ligjore dhe vëren se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe Kornizës Shqiptare të Kurrikulës së Arsimit Parashkollor, si dhe synon formim të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga takimi me stafin e programit, me studentët, me përfaqësues të NJSBC-së konstatojmë se për përmirësimin e programit departamenti konsultohet me mësuese të kopshteve, me drejtoresha të kopshtesh, me mentorë të institucioneve ku zhvillohet praktika profesionale, me stafin e Zyrës Arsimore Shkodër (ZVAP) me të cilët zhvillohen takime, por dhe zhvillimin i Konferencës Rajonale të Tregut të Punës pas diplomimit është në mbështetje për programin e studimit. Evidentohet gjithashtu se NJSBC e FSHE-së dhe Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave, Standardeve dhe Kërkimit Shkencor sjellin feedback mbi programin e studimit, të marrë nga studentët me anë të pyetësorëve. Pedagogët përmendin dhe ndikimin që ka sjellë përdorimi i Manualit të Cilësisë dhe Paketa e Instrumenteve Matëse të Cilësisë në mbledhjen e të dhënave për përmirësimin e programit të studimit <sup>51</sup> .

<sup>50</sup> Evidencat 1.1, 2.25. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Regjistrimi, diplomimi e punësimi (2019-2022)

<sup>51</sup> Evidencat 1.6, B, X, 2.22, 2.23, 2.18, Evidenca XVI, X, 2.24, 2.25. (Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Vendim i formimit të GVB-së; Manuali i cilësisë: Feedback pyetësori nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe vlerësimi të Standardeve; Feedback pyetësori NJSBC; Mbledhje Departamenti

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me stafin, me me përfaqësues të Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë dhe me studentët rezulton se ata informohen me nevojat e tregut të punës sidomos në zonën e veriut, u merret mendimi për programin e studimit. Njësia bazë ngarkon një pedagoge për të ndjekur punësimin e tyre. Studentët janë të përfaqësuar në Senat dhe në Këshillin studentor<sup>52</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore dhe nga takimi me stafin rezulton se programi i studimit ka reflektuar zbatimin e standardeve zyrtare të në rrafshin e përmbajtjes shkencore dhe të asaj didaktike. Nga ana tjetër departamenti bashkëpunon me mentorë dhe mësuese të kopshteve për përmirësim të vijueshëm të programit<sup>53</sup>.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<p><b>.Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

Mësuesi mbi Relacionin e Pyetësorit të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë; Vendim- Rregullore e sa per KSGC; Rregullorja e programit; Konferenca mbi Tregun e Punës në USH; Regjistrimi, diplomimi e punësimi (2019-2022).

<sup>52</sup>Evidencat 2.26, 1.3, 2.27, 2.28, Evidenca XXXI, XXXIII, B.( Vendim për gjurmimin e punësimin të studentëve; Marrëveshja me DRAP Lezhë; Vendim -Miratim kuota e kriterë; Studentë fitues në Këshillat e universitetit; Urdhër për fillimin e zgjedhjeve të Këshillave Studentorë: Rregullore e Këshillave Studentor” Vendim i formimit të GVB-së)

<sup>53</sup>Evidencat 2.16, 2.23, 1.1.(Syllabuse; Feedback pyetësori NJSBC; Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”.

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, nga takimet me stafin e programit dhe me studentët evidentohet përdorimi i formave dhe rrugëve të larmishme të proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënit, të tilla si: leksionet, seminarat, laboratorët, detyrat e kursit/ esetë, praktikat profesionale, orët e hapura, etj. Evidentohen veprimtari mësimore që ndahen në: a) mësim në auditor, si leksione, orë të hapura, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor; b) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo pranë subjekteve publike ose private. Stafi i programit përmendi se ata zhvillojnë me studentët forma të larmishme të mësimdhënies dhe të të nxënit që kanë në thelb ndërveprimin aktiv, pedagogjik duke përdorur metoda aktive si: video ilustruese, shpjegim përmes imazheve dhe shembujve të pasqyruar në PPT, dinamika individuale dhe grupi, modele të ndryshme të zhvillimit të orës mësimore, lojë me role, skeda vetëvlerësuese e materiale plotësuese didaktike, etj. Risi konsiderohet nga stafi dhe trajtimi i elementeve të shkollës gjithpërfshirëse në procesin mësimor. Identifikohet lehtë përdorimi i platformës TEAMS, jo vetëm gjatë periudhës së pandemisë, por ajo përdoret dhe tani në komunikimet me studentët për literaturën mësimore apo për lajmërimi të ndryshme. Stafi vlerëson të rëndësishme zhvillimin e praktikave profesionale në shkolla sepse studentët njihen dhe aplikojnë realisht me fëmijët e moshës shkollore njohuritë e marra në auditor. Nga vizita në IAL u vëzhguan dhe laboratorët e informatikës dhe ato të shkencave të natyrës, të cilët janë një mbështetje e mirë për të aplikuar apo zhvilluar më shumë njohuritë në fushën e edukimit<sup>54</sup>.</p>

<sup>54</sup> Evidencat 1.6, 1.27, II, XX, 2.2, 1.41, XII, XIII. ( Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Analiza e punës mësimore-shkencore, Departamenti i Mësuesisë; Rregullore e studimeve në USH; Platforma Microsoft Teams; Procedurat për zhvillimin e praktikës profesionale; Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për program studimi (Tab. 5); Kodi i Etikës: Guida për studentët;

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit konstatojmë se ata respektojnë diversitetin dhe nevojat e ndryshme të studentëve nëpërmjet zbatimit të formave, mënyrave dhe metodave alternative të mësimdhënies dhe të nxënit në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, por dhe me anë të Platformës Teams ku vendosen në të materiale të ndryshme të studimit, leksione, prezantime, detyra etj. Nga analiza e programit të studimit, evidentohet se ky program ofron një larmi lëndësh e fushash studimi gjë që e orienton dhe e drejton personelin akademik drejt formave, mënyrave, metodave e mundësive alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Identifikohet se shpesh janë të ftuar në mjediset e IAL-së specialistë të fushave të ndryshme (punonjës socialë, mjekë, infermierë apo vullnetarë të KKSH), të cilët ndajnë me studentët përvojat e punës së tyre. Në IAL vumë re re ka infrastrukturë të favorshme për levizjen dhe akomodimin në shkollë të studentëve me nevoja të veçanta<sup>55</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga takimi me stafin e Departamentit evidentojmë se Njësia bazë mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave profesionale të mësimdhënies, duke u mundësuar trajnime pedagogëve rreth metodave të shumëllojshme, pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Këto veprimtari pasqyrohen në faqen zyrtare të USH-së përmes websitit të tij si dhe adresës elektronike të personelit akademik<sup>56</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe</p>	<p>Nga takimet me pedagogët, me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe me studentët konstatojmë se personeli akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, si: demonstrime, ligjërata, veprimtari praktike, punë në grupe, kërkime në internet, etj., sipas tematikave dhe fushës që lëvron. Konstatojmë se stafi trajnohet në vijimësi me anë të Zyrës së Ekselencës për përmirësimin dhe rinovimin e metodave më të fundit të mësimdhënies. Në çdo fillim viti apo semestri, pedagogu i njej studentët me programin e lëndës, detyrat, detyrimet, përmbajtjen e lëndës dhe merr edhe një feedback të drejtëpërdrejtë nga studentët lidhur me lëndën. Pedagogët, në mënyrë të vazhduar realizojnë një feedback me studentët në fund të lëndës për të marrë një vlerësim të shpejtë për lëndën dhe hapësirat e mundshme që ata i vlerësojnë të nevojshme për ndryshim, si dhe stafi përdor platformat Google Classroom, TEAMS, LMS. Duke qenë Departament për mësuesinë rekomandojmë që të hartohet një</p>

<sup>55</sup> Evidencat 1.1, 1.23, 1.26, 1.27, 1.28, 3.2, 3.3, XX.( Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Lista e përfituesve nga trajnimet e LTEV: Model certifikate trajnimi LTEV; Analiza e punës mësimore-shkencore, Departamenti i Mësuesisë; Aktivitet me pedagogët e rinj “ Flipped classroom”; Aktivitet – Media and Literacy; Rregullore e studimeve në USH;.

<sup>56</sup> Evidencat 1.1, 1.4, 1.32, 1.34. (Programi i studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Marrëveshje me KKSH, dega Shkodër; Aktivitet me KKSH Shkodër & Departamentin e Infermierisë dhe për vullnetarizmin;)



ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	udhëzues për metodologjinë dhe të nxënësit ndërveprues për të rriturit, produkt që të jëtë në ndihmë të IAL-së <sup>57</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga takimet me stafin dhe me studentët konstatojmë se pedagogët vlerësojnë shumë feedback-un e studentëve që merret me anë të pyetësorëve dhe i mbajnë në konsideratë për të përmirësuar dhe për të sjellë risi në mësimdhënie me anë të përdorimit të metodologjive dhe teknologjive të mësimdhënies. Departamenti realizon vlerësimin e pedagogëve dhe kjo konsiderohet një rrugë e efektshme për përmirësim të vijueshëm <sup>58</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Nga takimi me dekanin dhe me përfaqësues të NJSBC konstatojmë se IAL-ja bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, neni 37, pika 1 dhe neni 38, pika 1/d, Statutin e USH-së, neni 17, pika 1, pika 6/r dhe me propozim të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Shkresë nr. 2493, në vitin 2019, ka miratuar Rregulloren e Zyrës së Ekselencës. Gjithashtu u ndryshua edhe emërtimi nga Qendra e Ekselencës në Zyrë e Ekselencës (me Vendim nr. 249, datë 17.7.2019). Misioni i kësaj zyre është rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në USH <sup>59</sup> .
<b>Konkluzione</b>	GVJ bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit III.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin,

<sup>57</sup>Evidencat 1.27, 1.12, 1.13, 1.14, 3.7, 3.1, 3.2, 2.16, XX, XXV ( Analiza e punës mësimore-shkencore, Departamenti i Mësuesisë; Nr. i personelit akademik (tituj/grada) (Tab. 1 & 2); Cilësia e stafit (Tab. 6); Kualifikimi i stafit (Tab.7); Zyra e Ekselencës (Ndryshim emërtim dhe Rregullore; Trajnime stafi në USH; Aktivitet me pedagogët e rinj “ Flipped classroom”); Syllabuse;Rregullore e studimeve në USH; Platforma LMS MOODLE;.

<sup>58</sup>Evidencat 1.27, 3.5, 3.6, 2.22, 2.23. ( Analiza e punës mësimore-shkencore; Analizë e punës mesimore - shkencore FSHE; Raportim model feedback nga studentët per pedagogun; Feedback pyetësori nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe vlerësimit të Standardeve; Feedback nga NJSBC;)

<sup>59</sup>Evidenca 3.7. Zyra e Ekselencës (Ndryshim emërtim dhe Rregullore)

	që sigurojnë arritjen e rezultateve të planifikuara. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, nga diskutimi me pedagogë dhe me studentë evidentojmë se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, si dhe sjelljet etike përcaktohen në Rregulloren e Studimit të USH-së, por ato bëhen publike dhe u komunikohen studentëve nga ana e pedagogëve të secilës lëndë/modul në fillim të lëndës. Kjo rregullore është e publikuar edhe në faqen zyrtare të USH-së. <sup>60</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga nga diskutimi me pedagogë dhe me studentë evidentojmë se ditën e parë të zhvillimit të mësimit për çdo lëndë titullarët e tyre u prezantojnë studentëve metodologjinë e testimit (vlerësimin e vazhduar, vlerësimin në provim) që lidhen me vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Anëtarët e stafit akademik prezantojnë para studentëve të gjitha elementet e lartpërmendura; marrin pyetje dhe reagime dhe ngarkojnë në sistem temat që do të zhvillohen për të gjitha javët. Ky informacion aksesohet nga studentët gjatë gjithë vitit akademik <sup>61</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	Nga shqyrtimi i Rregullores së USH-së (neni 22) dhe nga bisedat me stafin dhe me studentët konstatojmë se mënyra e vlerësimit të studentëve bazohet në vlerësimin e vazhduar dhe provimin e lëndës. Në rregulloren përkatës janë të përcaktuara mundësinë e realizimit të modelit të vlerësimit brenda kufinjve: 40% me 60% (ku 40 pikë studenti ka për detyrim t'i fitojë gjatë vlerësimit të vazhduar dhe 60 nga provimi i lëndës) apo 30% me 70%, në varësi të planifikimit që bën pedagogu

<sup>60</sup> Evidencat II, 1.5, 1.6, 1.28, 2.16, (Rregullore e studimeve në USH; Rregullore e FSHE-së, Rregullore e programit të studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Rregullore e Departamentit Mësuesi; Syllabuse)

<sup>61</sup> Evidencat II dhe 2.16. (Rregullore e studimeve në USH; Syllabuse)

demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	respektiv i lëndës, ku në përgjithësi zbatohet forma e organizmit të vlerësimit 30% me 70%. Sa i takon provimit final për lëndën, secili pedagog, bazuar në Rregulloren e studimeve, ka të drejtë të përcaktojë në programin e tij cilën formë provimi mendon të realizojë me studentët si: provim me shkrim, me gojë apo të kombinuar, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara <sup>62</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Siç është përmenduar dhe më lart personeli akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies që kanë në fokus studentin, si: demonstrime, ligjërata, vizita në kopshte, veprimtari praktike, punë në grupe, kërkime në internet, etj., sipas tematikave dhe fushës që lëvtron. Konstatohet se stafi trajnohet në vijimësi me anë të Zyrës së Ekselencës për përmirësimin dhe rinovimin e metodave më të fundit të mësimdhënies. NJSBC kontribuon në këtë proces lidhur me identifikimin e nevojave për përmirësim të vijueshëm me anë të pyetësorëve dhe të dhënave që mblidhen nga studentët <sup>63</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i programeve lëndore dhe nga bisedat me stafin akademik rezultojnë se format dhe metodat e mësimdhënies variojnë në varësi të mënyrës se si çdo pedagog/e koncepton organizimin e lëndës/modulit, ku secili prej tyre përfshin në programin e tij forma të larmishme të përfshirjes së studentëve si: detyra kursi, projekte, punë në grupe, etj <sup>64</sup> .
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit III.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatojnë se IAL zbaton rregulloren dhe procedurën të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton

<sup>62</sup> Evidencat II, 3.8, 3.9, 3.10, 1.36, 1.37.(Rregulloren e Studimeve në USH; Format e kontrollit të njohurive (Tab .15; Studentët në Punën shkencore (Tab. 22); Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (Konferenca 1&2); Konferencat e Departamentit Mesuesi 1&2; Konferenca online e Departamentit Mesuesi;)

<sup>63</sup> Evidencat 1.38, 1.39, 2.23, 3.6.( Aktivitet - Autizmi përmes perspektivave të ndryshme; Aktivitet – Ekspozitë me studentët në art pamor; Feedback pyetësori NJSBC; Raportim model feedback nga studentët për pedagogun;)

<sup>64</sup> Evidencat 2.16, 1.38,1.35, 1.34.(Syllabuse; Aktivitet - Autizmi përmes perspektivave të ndryshme; Aktivitet – Ekspozitë me studentët në art pamor;Aktivitete të Departamentit;)

	zbatimin e tyre. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullores së USH) dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatojmë se testimi dhe vlerësimi i njohurive, i dijeve dhe aftësive profesionale për studentët realizohet gjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet dy formave të zbatuara, si vlerësimi i vazhduar që zë 20%-40% dhe vlerësimit përfundimtar që zë 60%-70%. Pedagogët dhe studentët citojnë se mënyrat e vlerësimit të vazhduar që aplikohen janë detyra apo projekte kursi, kolekiume apo teste të ndërmjetme me shkrim, detyra në grup apo studime rasti, si dhe provimi final i lëndës <sup>65</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Konstatojmë se USH po zbaton sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit Clean Score të financuar nga AADF <sup>66</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullores së USH) dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatojmë se Vlerësimi përfundimtar i lëndës është rezultat i dy përbërësve që lidhen me vlerësimin e vazhduar me përbërësit përkatës, sipas programit lëndor (syllabusit), si dhe vlerësimit në provim, nëse lënda është provim. Nëse lënda është firmë, forma e shlyerjes së firmës bazohet në Rregulloren e studimeve (neni 24). Vlerësimi i vazhduar zë 20%-40% kurse vlerësimi përfundimtar zë 60%-70%. Përcaktimi i raportit mes këtyre dy përbërësve, vlerësim i vazhduar dhe vlerësim në provim, përcaktohet në rregulloren e USH-së (Neni 22) dhe evidentohet në programin e çdo lënde. Të gjitha detyrimet janë të përcaktuara në

<sup>65</sup>Evidencat II, 1.6, 2.16.(Rregullore e studimeve në USH: Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Syllabuse;)

<sup>66</sup>Evidencat XXI dhe 3.11. (Projekti Clean Score; Raportim Clean Score mbi provimet në FSHE)

	programin e lëndës, i cili hartohet nga pedagogu përgjegjës i lëndës dhe miratohet nga departamenti <sup>67</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullores së USH) dhe nga takimet me stafin akademik dhe me studentë konstatojmë se Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme të kontrollit gjatë semestrit, si: provimi i ndërmjetëm, punë laborator, detyrë kursi, provim final. Ky vlerësim shoqërohet me komente që lidhen dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Korigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 7 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni bën ballafaqimin me studentët ditën e caktuar të dhënies së rezultateve. Parashikohen procedura për ankimimin e studentëve lidhur me korigjimin e provimeve, ku sipas rregullores, studentëve i jepet një afat një ditor (brenda ditës së shpalljes së rezultateve) për të rishikuar provimin, për të kuptuar ku ka gabuar dhe për t'u këshilluar me pedagogun në vijim <sup>68</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga analiza e Rregullores së USH dhe ajo e programit, por dhe nga diskutimet me pedagogët dhe studentët konstatojmë se në provime dhe në paraqitje të temave dhe detyrave zbatohen rregulla dhe procese që lidhen me monitorimin dhe me zbatimin etik, antiplagjiaturë të krijimeve të studentëve. Nga ana tjetër zbatohen me rreptësi rregulla që persona të jashtëm nuk lejohen në sallën e provimit, ku komisioni ka të drejtë të ndërpresë provimin dhe të kërkojë ndihmën e të gjitha instancave (deri tek organet e ruajtjes së rendit publik) për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit. Në rastet kur provimi është me zë, studentët që deri në atë çast e kanë kryer provimin, nuk provohen më. Studenti konsiderohet mbetës në provim kur shkel elementet e Kodit të Etikës, sipas përcaktimeve të detajuara në rregullore (detyrimi i studentëve për të mos kopjuar në provime, ose punën e dikujt tjetër, për të mos fabrikuar të dhëna dhe respektuar dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë dhe personelit akademik e atij mbështetës <sup>69</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen	Nga analiza e dokumentacionit që lidhet me vlerësimin e studentëve por dhe nga bisedat me pedagogë dhe me studentë konstatojmë se studentët informohen në kohë për arritjet e tyre (ata presin deri në 7 ditë për

<sup>67</sup>Evidencat 2.5, 3.12. (Model Syllabus; Model tezë provimi & Proces-verbal provimi;)

<sup>68</sup> Evidenca II dhe 2.9. (Rregullore e studimeve në USH; Marrje tituj e grada në Departamentin e Mësuesisë;)

<sup>69</sup> Evidenca II dhe XII. (Rregullore e studimeve në USH; Kodi i Etikës në USH;)

në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	marrjen e notës).Ekzistojnë procedura të zbatueshme për ankimim, kurse rezultatet e kontrollit të dijeve për vlerësimin e vazhduar të studentit jepen orën e fundit të seminarit <sup>70</sup> .		
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Siç është përmenduar dhe më lart pas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar dekanit të fakultetit Kërkesa pastaj i dërgohet departamentit, i cili krijon një komision ad-hoc për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës <sup>71</sup> .		
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga bisedat me studentët konstatojmë se Komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti merr vendim për rivlerësimin. Vendimi që merr ky komisioni "ad hoc" mbi rivlerësimin e provimit është i formës së prerë dhe depozitohet në departament dhe në sekretarinë mësimore. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem.Konstatojmë se gjatë viti të fundit akademik 2022-2023 nuk ka patur asnjë kërkesë për ankimim rezultati <sup>72</sup> .		
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kritereve 1-8 të standardit III.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti, duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi III.4

<sup>70</sup> Evidenca II (Rregullore e studimeve në USH nenet 29 dhe 30;)

<sup>71</sup> Evidenca II (Rregullore e studimeve në USH neni 30;)

<sup>72</sup> Evidencat 1.6 dhe II. (Rregullore e programit të studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Rregullore e studimeve në USH;)

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Nga diskutimi me stafin akademik të programit konstatojmë se programi zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, duke iu mundësuar atyre kompetencat e domosdoshme për tregun e punës. Stafi i programit konkludon se programi zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, sepse ky proces bëhet i mundur nëpërmjet mënyrës se si çdo pedagog/e koncepton organizimin e lëndës/modulit, ku secili/a prej tyre përfshin në programin e tij/të saj forma të larmishme të përfshirjes së studentëve, si: detyra kursi, projekte, punë në grupe, etj<sup>73</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Nga analiza e programeve lëndore, e planit mësimor dhe diskutimi me pedagogët e programit theksohet se programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që studentët të marrin njohuri teorike dhe praktike për veprimtari të ndryshme në fushën që parashikon programi. Në kurrikul janë përfshirë gjerësisht lëndë dhe module që mundësojnë formimin bazë (përgatitje metodologjike), lëndë karakterizuese dhe përgatitje për disiplinën shkencore. Mendojmë se ky program garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, atë humane e sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj) përmes lëndëve që ajo ofron, si: Teknologji në Edukim, Sociologji, Shprehi në Komunikim, Didaktika, Gjuhë Angleze, Gjuhë Frënge, Edukim Qytetar Demokratik, etj<sup>74</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore (syllabuset), por dhe nga takimi me pedagogët e programit rezulton se programet lëndore që zhvillohen, rishikohen dhe pasurohen çdo vit nga pedagogu përgjegjës dhe përgjegjësi i programit të studimit. Identifikuam se pedagogët mbështeten në literaturë vendase dhe të huaj për t'u ofruar studentëve një kurrikul sa më zhvilluese dhe mbështetëse. Gjatë zbatimit të syllabusit, pedagogët analizojnë pikat e forta dhe të dobëta të programit, pas të dhënave të përpunuara të pyetësorëve të studentëve që vijnë nga NJSBC. Në këtë mënyrë, secili/a pedagog/e analizon çështjet e</p>

<sup>73</sup> **Evidencat 1.1, 2.16, 2.1.** (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Syllabuse; Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) (Tab. 9);)

<sup>74</sup> **Evidenca 1.1 dhe 2.16.** (Programi i studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"; Syllabuse)

<p>studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmyllëse.</p>	<p>ndryshme, të cilat janë konstatuar gjatë trajtimit si të panevojshme apo të paplotësuara dhe kompletohen duke synuar përsosjen e qëllimit të lëndës. Në departament diskutohen çështje të ndryshme për përmirësimin në vazhdimësi të procesit mësimor dhe të syllabuseve. Departamenti zbaton proceduar të aplikueshme për hartimin dhe miratimin e programeve lëndore në fillim të vitit akademik ku secili/a pedagog/se paraqet dhe risitë apo përmirësimet që ka bërë<sup>75</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga analiza e programeve lëndore si dhe bisedat me stafin e programit konstatojmë se në përfundim të çdo lënde/moduli pedagogu/ia vë në dukje përmbushjen e pritshmërive/rezultateve të të nxënit, orienton vëmendjen e studentëve në pikat kyçe dhe nxit përsëritjen dhe përvetësimin e këtyre dijeve për t'i ndihmuar studentet që të brendësojnë këto dije dhe t'i zbatojnë ato në profesionin e tyre në të ardhmen. Programet lëndore paraqesin kompetencat që synohen të formohen nga studentët në laboratorë dhe praktika profesionale Stafi konsideron të rëndësishme metodologjitë e mësimdhënies dhe të nxënit me në qendër studentin lidhur me formimin e kompetencave të domosdoshme dhe ata vlerësojnë bashkëpunimin dhe përvojën disavjeçare të pedagogëve në Universitetin e Podgoricës dhe programet Erasmus + në favor të mobilitetit të studentëve<sup>76</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Nga diskutimi me pedagogët me kohë të plotë dhe me kontratë rezultojnë se ata zhvillojnë orë mësimi të hapura, të cilat ndërthurin të reja me të fundit në fushën e mësimdhënies dhe teknologjisë. Në ndihmë të tyre janë dhe projektet ku pedagogë të këtij programi studimi, apo edhe të FSHE-së kanë qenë të përfshirë. Vitet e fundit Departamenti ka organizuar një konferencë të përvitshme kombëtare, të organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Psikologëve Shqiptarë. Kështu u është</p>

<sup>75</sup> Evidenca 2.17 dhe 2.16. (Miratim model syllabus; Syllabuse)

<sup>76</sup> Evidencat 2.16, 3.9, 3.10, 1.36, 1.31, 1.32, 1.39, 1.25. (Syllabuse; Studentë në Punën shkencore (Tab. 22); Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (Konferenca 1&2); Konferencat e Departamentit Mesuesi 1&2 dhe konferenca online; Projekti IDEA; Aktivitete me KKSHE dhe Departamentin e Psikologjisë: Vendim Rektorati për hapjen e LTEV;)



brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	ofruar studentëve përfshirja dhe promovimi i risive shkencore në fushën e edukimit, duke nxitur edhe bashkëpunimin me vetë studentët. Një traditë e mirë është edhe vazhdimësia e bashkëpunimit me shoqatën e Kryqit të Kuq Shqipëtar në aktivitete të ndryshme <sup>77</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit III.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja ka funksionale struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies në programet e studimit. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Jo përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit, por dhe nga takimi me stafin e programit rezulton se Departamenti i Mësuesisë harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Në një mbledhje të veçantë të departamentit diskutohet në lidhje me lëndët që do të përfshihen në provimin e diplomës, variantet e tezave, pikët e secilës lëndë dhe, gjithashtu, përcaktohet modeli i tezës së provimit. Po ashtu, diskutohet edhe për rregullin e sekretimit të provimeve dhe korrigjimit. Sa i takon mbrojtjes së diplomës me temë, përcaktohen pedagogët udhëheqës, afatet e kohëzgjatjes së realizimit të punimit dhe dorëzimit të saj në departament, si dhe diskutohet në lidhje me numrin e pedagogëve që do përbëjnë komisionin si dhe oponentët. Kjo mbledhje mbahej me procesverbal dhe vendimet e saj u komunikoheshin studentëve <sup>78</sup> .

<sup>77</sup> Evidenca XLI dhe 1.2, 1.38, 1.35, 1.34, 3.13, 3.18. (Rregullore e administratës në USH; Lista e marrëveshjeve institucionale; Aktivitet - Autizmi përmes perspektivave të ndryshme; Aktivitet me Universitetin "Marin Barleti"; Aktivitet Vullnetarizmi: Konferenca ndërkombëtare-Transhumanca; Programi i konferencës TEAVET;)

<sup>78</sup> Evidencat 3.19 dhe 1.6. (Procedurat e diplomimit; Rregullore e programit të studimit BA në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor";)

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët ata shprehen se ndihmohen, janë të mbështetur dhe të lehtësuar lidhur me informacionet e domosdoshme për ta që kanë të bëjnë me përballimin e lëndëve, me literaturën, me vlerësimin e arritjeve. Ata kanë mundësi të mbështeten nga stafi akademik dhe ai mbështetës, por dhe me anë të ndërveprimit online me faqen e IAL-së. Sa i përket vlerësimit përfundimtar, konstatojmë se ai është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga drejtuesi i departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Për ata që e mbrojnë me tezë në fillim të vitit të fundit të studimeve departamentet përcaktojnë fushat e studimit për punimet e diplomave. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit, duke firmosur tezën e diplomës. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Konstatojmë se për periudhën 2020-2023, studentët kanë finalizuar provën finale me anë të provimit<sup>79</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nga takimi me stafin, me Përgjegjësin e departamentit dhe Dekanin rezulton se Provimi i formimit/punim diplome realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik i departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga dekani. Komisioni i provimit përfundimtar përbëhet nga titullarët e lëndëve të përzgjedhura, të cilët hartojnë tezën e provimit final duke u mbështetur në literaturën dhe njohuritë që studentët kanë marrë gjatë viteve të shkollimit. Për programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor përfshihen lëndët: Psikologji edukimi, Psikologji zhvillimore, Pedagogji Parashkollore, Edukim muzikor<sup>80</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit, por dhe në bisedat me stafin e akademik të tij konstatojmë se Pedagogu udhëheqës i diplomës orienton dhe mbështet studentin për punimin e diplomës. Në këtë program studimi, këto vitet e fundit, studentët kanë zhvilluar provimin me shkrim dhe jo punim të diplomës, për arsye të zgjedhjes së tyre, por dhe për</p>

<sup>79</sup> Evidenca 3.19 dhe 3.20.(Procedura dhe procesverbali i diplomimit)

<sup>80</sup> Evidencat 3.19, 3.20, 3.21(Procedura dhe procesverbali i diplomimit; Diplomë dhe suplement diplome;)

<p>në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>arsye të mospërbushjes së kriterit të notës mesatare nga ana e studentëve<sup>81</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët konstatojmë se ata lehtësohen nga IAL-ja lidhur me procese kërkimore që bazohen në matje, analiza, testime, të cilat zhvillohen kryesisht në kopshtet ku bëhen praktikatat, me të cilat ka marrëveshje me DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër ku parashikohet në një nen të veçantë zhvillimi i veprimtarive kërkimore. Sa i takon rasteve që hartohet tezë diplome Rregullorja e USH ka përcaktuar me detaje përgjegjësitë e institucionit dhe udhëheqësit të diplomës, ku parashikohen edhe ndihma në përzgjedhjen dhe zbatimin e metodologjisë së studimit<sup>82</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit dhe Rregullores së USH, si dhe nga takimet me stafin akademik evidentojmë se zbatohen procedura zyrtare për përfundimin e provës finale. Kështu, në përfundim të provimit të formimit/mbrojtje e diplomës, studenti vlerësohet me notë (5-nota minimale për të kaluar dhe 10-nota maksimale), e cila i bëhet me dije nga komisioni përkatës. Në rastin e provimit vlerësimi nota është mesatarja e shumës së pikëve të secili anëtar të komisionit pjesëtuar me numrin e anëtarëve të komisionit. Teza ka të paravendosura pikët për secilën pyetje. E ngjashme është edhe mënyra e vlerësimit për studentët që realizojnë mbrojtjen e diplomës me temë, por këtu operohet me sistemin e notës, jo të pikëve. Komisioni përbëhet nga 3-5 anëtarë. Mbrojtja e diplomës me punim diplome bëhet para një komisioni të përbërë prej 5 anëtarësh, të propozuar nga drejtuesi i departamentit dhe miratuar nga dekani i fakultetit. Në përfundim të procesit, kryetari i komisionit hedh rezultatin e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave. Procesverbali i gjeneruar nga sistemi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përfundimtar<sup>83</sup>.</p>

<sup>81</sup> Evidenca 3.21.( Diplomë dhe suplement diplome)

<sup>82</sup> Evidencat 1.3.(Marrëveshja me DRAP Lezhë)

<sup>83</sup> Evidenca 3.19, Evidenca 3.20.( Procedura dhe procesverbali i diplomimit)

<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Nga takimet me studentë, me sekretarinë, me Drejtorinë e Kurrikulës rezulton se pas përfundimit të studimeve, studenti plotëson dokumentacionin e kërkuar dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës (anglisht dhe shqip), të miratuara nga MAS. Studenti mund të pajiset me programet e lëndëve në varësi të kërkesës së tij, sipas nevojës. Ky dokumentacion (diplomë dhe suplement) i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Kurrikulës, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve<sup>84</sup></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, nga bisedat me Përgjegjësen e Departamentit, si dhe me studentë konstatojmë së institucioni ruan gjatë viteve të studimit kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen, ku respektohen të drejtat e privatësisë. Studentët shprehen se ata, në rrethime të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Këto të dhëna janë të regjistruara dhe të ruajtura pranë sekretaritë mësimore përkatëse, që përbën regjistrin themeltar. Po ashtu u konstatua se USH-ja ka në funksion të plotë që nga viti 2013 sistemin e menaxhimit të studentëve “ESSE3” dhe tashmë sistemin e Pitagorës, i cili ruan informacionin në formë elektronike, krahas asaj të shkruar. Sekretaritë mësimore dispononin një regjistër bazë të studentëve me të dhëna. Ky regjistër, në formë të shkruar dhe elektronike, pasqyron vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhënat për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj. Të dhënat bazë i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore<sup>85</sup>.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja zbaton procedura zyrtare dhe të efektshme sa i takon detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Për këto arsye GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbylljet pjetërisht</b></p>	<p><b>Përmbylljet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbylljet plotësisht</b></p>

<sup>84</sup> Evidencat 3.21, 1.6, 3.20, II. (Diplomim dhe suplement diplome; Rregullore e programit të studimit BA në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; Proceverbali i diplomimit; Rregullore e studimeve në USH)

<sup>85</sup> Evidencat XXII, XLIX, 3.21, (Platforma Esse 3; Platforma SMUSHK; Diplomim dhe suplement diplome; <https://ushk.pitagora.rash.al/login>.)

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																						
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në RVB e programit të studimit si dhe gjatë vizitës në institucion, për tre vitet e fundit akademike (2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022), konstatohet që, personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij program studimi, respekton kriteret ligjore në fuqi, si dhe ofron ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies.  Bazuar në RVB dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit BA Arsim Parashkollor, bazuar në tabelat 2 të Evidencë 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada) <sup>86</sup> është:																																																						
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2022 -2023</th> <th colspan="2">2021 -2022</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr proces</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>8</td> <td>6</td> <td>8</td> <td>5</td> <td>9</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/grada	2022 -2023		2021 -2022		2020 - 2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	-	1	-	2	-	Prof.As.Dr	-	-	-	-	-	-	Dr/PhD	5	1	4	1	4	1	Dr proces	1	-	-	-	-	-	Msc	1	5	3	4	3	3	Në total	8	6	8	5	9
Tituj/grada	2022 -2023		2021 -2022		2020 - 2021																																																		
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																	
Prof.Dr	1	-	1	-	2	-																																																	
Prof.As.Dr	-	-	-	-	-	-																																																	
Dr/PhD	5	1	4	1	4	1																																																	
Dr proces	1	-	-	-	-	-																																																	
Msc	1	5	3	4	3	3																																																	
Në total	8	6	8	5	9	4																																																	

<sup>86</sup> Evidencë 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada). Evidencë 1.15 Ngarkesa totale e PAE-PAK 2022-2023.

	<p>Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu I, pika 3.3.c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”, si dhe në shkresën e dërguar Përgjegjësi i Departamentit konstatohet se për vitin akademik 2022-2023 raporti PAK/PAE, i Departamentit të Mësuesisë është 73.7% / 26.3%.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatuam se, personeli akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të Mësuesisë, mbulon ngarkesën dhe zhvillon aktivitetin mësimdhënës, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe konform Udhëzimit nr. 29, dt. 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”<sup>87</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në takimin me Drejtorinë e burimeve njerëzore konstatuam se, institucioni derdh rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore të stafit akademik dhe të studentëve që zhvillojnë praktikat mësimore pranë shkollave përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, në takimin me personelin akademik, të programit të studimit, evidentohet qëndrueshmëri kontraktuale, si dhe korrektësi në pagesat e kryera, bazuar në legjislacionin në fuqi<sup>88</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Konstatuam se, vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore<sup>89</sup>.</p> <p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DM. Bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe</p>

<sup>87</sup> Evidencë 1.19 Ngarkesa totale e personelit 2020-2023 (Departamenti Mësuesi).

<sup>88</sup> Evidencë 4.4 Vendim sigurime shoqërore dhe shëndetësore; Evidencë 4.2 Kontrate PAE; Evidencë 4.3 Kontrate PAK.

<sup>89</sup> Evidencë 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada); Evidencë 1.13 Cilesia e stafit; Evidencë 1.14 Kualifikimi i stafit.

	PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit <sup>90</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Konstatuam se, Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka punonjës ndihmës për realizimin e këtij program studimi në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mësimore si dhe në realizimin e orëve laboratorike, për natyrën specifike të këtij program studimi <sup>91</sup> .  Gjatë vizitës në institucion konstatuam se FSHE dispononte disa laboratore në fuksion të këtij program studimi si laborator i edukimit figurativ, edukimit muzikor, i teknologjisë në edukim si dhe ai i trajnimeve për edukimin e vazhduar, të cilët administrohet nga lektorët përkatës, stafi ndihmës mësimor si dhe nga specialisti i IT i FSHE-së <sup>92</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se, institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së USH <sup>93</sup> , në lidhje me strukturën analitike të FSHE, në rang njësie dhe personelin përkatës. Departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit <sup>94</sup> , të cilat arkivohen pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore të USH-së <sup>95</sup> .
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të ditur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën	Institucioni "USH" marrëveshje bashkëpunimi me DRAP Lezhë, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor për realizimin e praktikës profesionale dhe punës kërkimore të studentëve në terren për realizimin e temës së diplomës. USH merr përsipër deklarin e studentëve praktikantë lidhur me sigurimet shëndetësore, sigurimin e pedagogut mentor, ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë, ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës. ZVA Shkodër, merr përsipër, mundësimin e zhvillimit të

<sup>90</sup> Evidencë 4.2 Kontrate PAE; Evidencë 4.3; Kontrate PAK.

<sup>91</sup> Evidencë 37-XXXVII. ORGANIKA USH.

<sup>92</sup> Evidencë 4.5 Laboratori @TASK; Evidencë 38-XXXVIII. STRUKTURA AKADEMIKE.

<sup>93</sup> Evidencë 37-XXXVII. ORGANIKA USH.

<sup>94</sup> Evidencë 1.10 CV - Staf i brendshëm; Evidencë 1.11 CV- Staf i jashtëm; Evidencë 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada); Evidencë 1.13 Cilesia e stafit.; Evidencë 1.14 Kualifikimi i stafit.

<sup>95</sup> Evidencë 4.6 Moshë e stafit; Evidencë 2.12 CV-Staf mbeshtetes.

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>praktikave për studentët, sipas shkollave dhe nivelit të tyre të studimit, si dhe në dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë<sup>96</sup>.</p>		
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Personat përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e praktikës, profesionale mësuesi mentor dhe pedagogu përgjegjës, ndihmojnë studentët në realizimin e praktikës pasive dhe më pas asaj aktive<sup>97</sup>.</p> <p>Formularët dhe dosja e praktikës janë pjesë përbërëse e vlerësimit final të studentit, ku paraqesin në mënyrë të qartë veprimtaritë, orët, mënyrat dhe modelet e aplikuara përgjatë zhvillimit të procesit mësimor<sup>98</sup>.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, qartësisht të pasqyruara, GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit.</i></p> <p><i>Konstatuam gjithashtu, se Zyra e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DM dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program.</i></p> <p><i>Rezulton se, numri i stafit akademik të brendshëm të angazhuar (PAK) ka ardhë në rënie dhe ai me atë me kohë të pjesshme (PAE) në rritje, gjë e cila sjell prishje të raportit PAK/PAE sipas udhëzimit të sipërcituar.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që personeli akademik me kohë të plotë, për këtë program studimi, të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore, sipas legjislacionit në fuqi.</i></p> <p><i>Përsa me sipër, ky kriter ligjore të përmbushet kryesisht.</i></p>		
<p><b>Shtakalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>			

**Standardi IV.2**

<sup>96</sup> Evidencë 1.3 Marreveshja me DRAP, Lezhe.

<sup>97</sup> Evidencë 1.1 Programi i studimit BA. Arsim Parashkollor; Evidencë 1.2 Lista e marreveshjeve institucionale; Evidencë 1.3 Marreveshja me DRAP, Lezhe.

<sup>98</sup> Evidencë 1.40 Analize e Praktikës profesionale; Evidencë 2.2 Procedure për zhvillimin e praktikës profesionale.



**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se, për shkak të specificitetit që ky program studimi ka, kurset e këtij program studimi, zhvillohen në godinën e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, si dhe infrastruktura e universitetit përmban mjedise me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike për zhvillimin e jo vetëm të mësimdhënies, por dhe të veprimtarive artistike dhe kërkimore shkencore<sup>99</sup>. Disa nga mjediset më rëndësishme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies, por edhe të veprimtarive artistike dhe kërkimore shkencore janë:</p> <p>Salla e digjitale TASK<sup>100</sup>, salla për zhvillimin e kursit të artit figurativ, salla për zhvillimin e artit muzikor e pajisur me instrumente muzikore për realizimin jo vetëm të kursit<sup>101</sup> por edhe të aktiviteteve të ndryshme që organizojnë në bashkëpunim me institucionet e tjera bashkëpunuese.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, disa nga mjediset mësimore, si: laboratorët<sup>102</sup> dhe biblioteka janë të pajisura me mjete e duhura elektronike dhe teknologjike, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, si dhe veprimtaritë artistike përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit ndërsa auditorët, në të cilët zhvillohen leksionet dhe seminarët kanë kushte të mira fizikem, <i>por kanë nevojë të pasjisen me mjetet e duhura teknologjike</i>.</p> <p>Institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet e duhura për student<sup>103</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të</p>	<p>Nga vizita e mjediseve, konstatuam se, klasat mësimore dhe laboratorët janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banga, karrike, pajisje teknologjike, tabela etj).</p>

<sup>99</sup> Evidencë 4.7 Planimetria FSHE.

<sup>100</sup> Evidencë 4.5 Laboratori @TASK.

<sup>101</sup> Evidencë 1.1 Programi i studimit BA. Arsim Parashkollor.

<sup>102</sup> Evidencë 4.5 Laboratori @TASK.

<sup>103</sup> Evidencë 4.7 Planimetria FSHE.

<p>objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Evidentuar se, FSHE ka një laborator kumpjuterik TASK<sup>104</sup>, laboratori i trajnimeve të edukimit të vazhduar<sup>105</sup>, salla për zhvillimin e kursit të artit figurativ, salla për zhvillimin e artit muzikor e pajisur me instrumente muzikore<sup>106</sup> me aparaturat përkatëse që janë të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor në kuadër të specifikës që ky program studimi ka.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, konstatuar se mjediset mësimore si zyra, studiot, klasat, laboratorët, sallat e performancës, janë të pajisuara me mjetet e nevojshme fizike, teknike dhe teknologjike, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimin teorik dhe praktik si dhe artistik<sup>107</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatuar se, FSHE disponon një laborator kumpjuterik TASK<sup>108</sup> ku janë të instaluar rreth 50 pajisje kompjuterike të ndërlidhjes së rrjetit kompjuterik si dhe laboratorin i trajnimeve të edukimit të vazhduar<sup>109</sup>.</p> <p>Rezulton, gjithashtu, se pranë Bibliotekës së USH ndodhet laboratori i informatikës (mediateka), i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t'i shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet 24 vendesh. Ai është në shërbim të studentëve me internet falas që iu vjen në ndihmë për përgatitjen e detyrave të kursit dhe diplomave. Interneti falas në këtë mjedis krijon kushte të favorshme për një studim online, mundëson konsultimin me materiale të ndryshme shkencore si dhe të mësuarin në distancë. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të USH, gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik<sup>110</sup>.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Gjithashtu konstatohet se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke</i></p>

<sup>104</sup> Evidencë 4.5 Laboratori @TASK.

<sup>105</sup> Evidencë 1.25 Vendi Rektorati per hapjen LTEV.

<sup>106</sup> Evidencë 1.1 Programi i studimit BA. Arsim Parashkollor.

<sup>107</sup> Evidencë 1.1 Programi i studimit BA. Arsim Parashkollor.

<sup>108</sup> Evidencë 4.5 Laboratori @TASK.

<sup>109</sup> Evidencë 1.25 Vendi Rektorati per hapjen LTEV; Evidencë 1.24 Memorandum LTEV.

<sup>110</sup> Evidencë 4.7 Planimetria FSHE.

	<i>përbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjendet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit si dhe realizimit e aktiviteteve të ndryshme artistike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion konstatoam se, literatura e për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga<sup>111</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Literatura bazë;</li> <li>- Literatura ndihmëse;</li> <li>- Periodik të huaj;</li> <li>- Periodik shqiptare;</li> <li>- Enciklopedi;</li> <li>- Revista Shkencore;</li> <li>- Gazeta mësuesi;</li> <li>- Punime teorike universitare dhe pasuniversitare të studentëve dhe pedagogëve;</li> <li>- Monografi shkencore të fushave të ndryshe mbi edukim, letërsinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe.</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Konstatojmë se, njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron <sup>112</sup> .

<sup>111</sup> Evidencë 4.8 Lista e librave BUSH; Evidencë 4.9 Botime te stafit USH (katalogu).

<sup>112</sup> Evidencë 4.8 Lista e librave BUSH.

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatojmë se godina aktuale e bibliotekës, është një godinë bashkëkohore me tre kate dhe me sipërfaqe rreth 3000 m<sup>2</sup>. Biblioteka ofron një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të tyre mediatekën, me 26 vende multimedia, si dhe tri salla leximi me 300 vende leximi në total.</p> <p>Godina e bibliotekës ka në përbërjen e saj edhe sallën e konferencave “Hoeflechner”, me një kapacitet 120 vende, e cila mundëson zhvillimin e një sërë aktiviteteve të karakterit akademik, mësimdhënës apo promovuese<sup>113</sup>.</p> <p>Shërbimi elektronik i bibliotekës ofrohet nëpërmjet dy sistemeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi i menaxhimit përmes të cilit biblioteka kryen katalogimin dhe shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) për audiencën e gjërë;</li> <li>• Sistemi i arkivit digjital ku përdoruesit mund të shfletojnë materialet elektronike;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë se biblioteka e USH-së, sot disponon një fond prej rreth 111 mijë librash. Fondet e bibliotekës në shqip dhe në gjuhë të huaj mbulojnë të gjitha fakultetet e universitetit.</p> <p>Biblioteka zotëron koleksione të pasura si:</p> <p>Fondin albano – ballkanologjik;</p> <p>Fondin shqip dhe të shkencave filologjike të albanologjisë;</p> <p>Fondin e huaj;</p> <p>Bibliotekën austriake;</p> <p>Fondin e periodikut shqip dhe të huaj;</p> <p>Fondin e fakulteteve.</p> <p>Rezulton se, ajo disponon një fond albano – ballkanologjik me vlerë të çmuar, një ndër më të pasurit në Shqipëri, i përbërë nga 35 libra të rrallë që datojnë që nga shek. XVI. Pjesë e këtij fondi është edhe periodiku i shtypit shqiptar për periudhën 1879 – 1944, mjaft i pasur gjithashtu. Gjithashtu, në arkiv ndodhen 297 tituj dhe nga këto 125 tituj janë koleksione të plota.</p>

<sup>113</sup> <http://bush.unishk.edu.al/biblioteka/>; Evidencë 4.8 Lista e librave BUSH.

	<p>Konstatuam, gjithashtu, se pasuri për Bibliotekën Universitare përbën edhe Biblioteka Austriake, e hapur në mjediset e saj që në vitin 2000. Sot kjo bibliotekë numëron rreth 14.000 libra, periodikë dhe cd/dvd. Kjo bibliotekë mbështetet në veprimtarinë e saj nga Ambasada Austriake në Tiranë dhe pasurimi i fondeve realizohet çdo vit nga Ministria Federale e Punëve të Jashtme të Austrisë.<sup>114</sup></p> <p>Për këtë program studimi rezulton se, institucioni disponon 753 libra, nga të cilat 90% në gjuhë shqipe dhe 10% në gjuhë të huaj<sup>115</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, menaxhimi i librave të bibliotekës është i realizuar nëpërmjet skedarëve dhe gjithashtu nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët.</p> <p>Rezulton se, Biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi” disponon 3 salla leximi (me 300 vende në total), në tre katet e godinës, si dhe 1 sallë pune në grup e pozicionuar në katin e parë, që ndihmon studentët në realizimin e detyrave të kursit në grup<sup>116</sup>.</p> <p>Ndërsa nëpërmjet platformës online ofron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Revista Elektronike</li> <li>• Kataloge Online</li> <li>• Projekti ERA 2012</li> <li>• Libraria Digjitale<sup>117</sup></li> <li>• Progetto Vatra<sup>118</sup> Willy Kamsi</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Rezulton se, Biblioteka ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në mjedisin e Mediatekës të cilin ndodhet dhe fondi i materialeve jo libër (kaseta, cd dhe dvd), numërohen rreth 700 materiale multimediale.</p> <p>Gjithashtu në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. Institucioni i ofron studentëve mundësi aksesimi nëpërmjet abonimit në revista shkencore online<sup>118</sup> si:</p> <p>Edward Elgar Publishing’s <a href="https://www.elgaronline.com/">https://www.elgaronline.com/</a></p>

<sup>114</sup> <http://bush.unishk.edu.al/biblioteka/>

<sup>115</sup> Evidencë 28-XXVIII. LISTA E BLERJEVE NGA BUSH 2021- 2022.

<sup>116</sup> <http://bush.unishk.edu.al/biblioteka/>

<sup>117</sup> <https://ulibrary.rash.al/>.

<sup>118</sup> <http://bush.unishk.edu.al/instrumente/revista-elektronike/>

	<p>Taylor &amp; Francis Online <a href="https://www.tandfonline.com/">https://www.tandfonline.com/</a></p> <p>IFLA Journal <a href="http://www.ifla.org/V/iflaj">http://www.ifla.org/V/iflaj</a></p> <p>Ariadne <a href="http://www.ariadne.ac.uk">http://www.ariadne.ac.uk</a></p> <p>D-Lib Magazine <a href="http://dlib.org">http://dlib.org</a></p> <p>Library of Congress Publications <a href="http://www.loc.gov/loc/pub">http://www.loc.gov/loc/pub</a></p> <p>LC Information Bulletin <a href="http://www.loc.gov/loc/lcib">http://www.loc.gov/loc/lcib</a></p> <p>Library of Congress Subject Headings weekly lists <a href="http://www.loc.gov/aba/cataloging/subject/weeklylist">http://www.loc.gov/aba/cataloging/subject/weeklylist</a></p> <p>LC Cataloging Service Bulletin <a href="http://www.loc.gov/cds/PDFdownloads/csb/index.html">http://www.loc.gov/cds/PDFdownloads/csb/index.html</a></p> <p>NLS Newsletter <a href="http://www.loc.gov/nls/newsletters/">http://www.loc.gov/nls/newsletters/</a></p> <p>Bullettino AIB <a href="http://www.aib.it/boll/boll.htm">http://www.aib.it/boll/boll.htm</a></p> <p>Bulletin des Bibliothèques de France <a href="http://bbf.enssib.fr/">http://bbf.enssib.fr/</a></p> <p>Ukrainian Book Institute Manual: <a href="#">Manuali</a></p> <p>Ukrainian Book for Children : <a href="#">Ukrainian Book for Children</a></p> <p>Ukrainian Book for Adults : <a href="#">Ukrainian Book for Adults</a></p> <p>si katalogut online të Bibliotekës universitare<sup>119</sup>:</p> <p>Katalogu Botëror WorldCat <a href="http://www.worldcat.org/">http://www.worldcat.org/</a></p> <p>Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Francës – CCFr <a href="http://ccfr.bnf.fr/portailccfr/servlet/LoginServlet">http://ccfr.bnf.fr/portailccfr/servlet/LoginServlet</a></p> <p>Katalogu i Bibliotekës Kombëtare të Gjermanisë <a href="http://dispatch.opac.d-nb.de">http://dispatch.opac.d-nb.de</a></p> <p>Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Italisë <a href="http://opac.sbn.it/opacsbn/opaclib">http://opac.sbn.it/opacsbn/opaclib</a></p> <p>Katalogu i Bibliotekës Kombëtare të Spanjës <a href="http://catalogo.bne.es/uhtbin/webcat">http://catalogo.bne.es/uhtbin/webcat</a></p> <p>Katalogu i Bibliotekës Britanike <a href="http://catalog.bl.uk/">http://catalog.bl.uk/</a></p> <p>Katalogu i Bibliotekës së Kongresit Amerikan <a href="http://catalog.loc.gov/">http://catalog.loc.gov/</a></p> <p>Index Translationum <a href="http://databases.unesco.org/xtrans/xtra-form.shtml">http://databases.unesco.org/xtrans/xtra-form.shtml</a></p> <p>gjithashtu edhe nëpërmjet librarise dixhitale U-Library<sup>120</sup></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatuam se, Biblioteka funksionon nëpërmjet Regjistrit themeltar të inventarit të koleksioneve bibliotekare, i cili është dokumenti bazë që pasqyron të gjitha materialet bibliotekare që kanë hyrë në bibliotekë që në krijimin e saj në mënyrë kronologjike. Regjistri i inventarit është dokument mbi bazën e të cilit</p>

<sup>119</sup> <http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/>

<sup>120</sup> <https://ulibrary.rash.al/>

<p>edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>bëhet inventari i bibliotekës. Në të regjistrohet çdo njësi që hyn në biblioteke dhe merr një numër që e identifikon atë si njësi unike midis tërë koleksionit të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve aksesimin nëpërmjet katalogu online të Bibliotekës së USH <a href="http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/">http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/</a> dhe bibliotekës digjitale të <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a> dhe oraret e shërbimit, për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve. Biblioteka punon e hëna në të premtë përgjatë orarit 8:00 – 19:00 dhe e shtune 8:00 – 13:00.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qënë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Konstatohet se, biblioteka dhe njësitë bazë kanë një komunikim të vazhdueshëm për pasurimin e fondit fizik dhe elektronik të fondit të titujve. Njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p> <p>Biblioteka bën përditësime periodike për shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit nëpërmjet Arkivës Dixhitale të BUSH<sup>121</sup>.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se, Biblioteka e USH ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe enciklopedi, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes të programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht përmbushet</b></p>	<p><b>Përmesisht përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përzabuset plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<sup>121</sup> Evidencë 28-XXVIII. LISTA E BLERJEVE NGA BUSH 2021- 2022.

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se USH, përdor sistemin e menaxhimit të studentëve “ESSE3” si dhe PITAGORA<sup>122</sup>.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit;</li> <li>● të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik;</li> <li>● të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet;</li> <li>● të dhëna për ecurinë akademike të studentit;</li> <li>● numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik;</li> <li>● të dhënat e studentëve që diplomohen<sup>123</sup>.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në Raportin vjetor të punës mësimore-shkencore të stafit akademik të USH<sup>124</sup>, rezulton se institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.</p> <p>Gjithashtu, rezulton se, nëpërmjet aplikacionit SMAK institucioni menaxhon aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të stafit akademik, nëpërmjet të cilit përgjegjësi i departamentit plotëson të dhënat për ngarkesën dhe veprimtaritë mësimore të stafit gjatë vitit akademik<sup>125</sup>.</p> <p>Nga vizita në institucion, konstatohet gjithashtu se Zyra e Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa Departamenti monitoron dhe nxit aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor<sup>126</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, konstatohet se ajo ruan të gjithë të dhënat në mënyrë elekttronike në platformën ESSE 3 dhe</p>

<sup>122</sup> Evidencë 22-XXII. PLATFORMA ESSE 3; Evidencë 23-XXIII. PLATFORMA PITAGORA.

<sup>123</sup> Evidencë 2.25 Regjistrimi, Diplomimi dhe Punesimi.

<sup>124</sup> Evidencë 17-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE 2022.

<sup>125</sup> Evidencë 24-XXIV. PLATFORMA SMAK.

<sup>126</sup> Evidencë 1.10 CV - Staf i brendshëm; Evidencë 1.11 CV- Staf i jashtëm; Evidencë 1.12 Numri i personelit akademik (tituj, grada); Evidencë 1.13 Cilesia e stafit; Evidencë 1.14 Kualifikimi i stafit; Evidencë 1.15 Ngarkesa totale e PAE-PAK 2022-2023.



<p>gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pitagora<sup>127</sup> si dhe ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna në formatin e Regjistrisë Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit.</p> <p><i>Nga ana tjetër, evidentohet që sekretaria FSHE-së nuk disponon një Rregullore për mënyrën e funksionimit të Sekretarisë Mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit PITAGORA<sup>128</sup>, rezultojnë se institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet sistemit LMS, institucioni vë në dispozicion të studentëve programin e lëndës, leksionet, materialet &amp; video mësimore, video prezantimet e studentëve, si dhe realizon takime online<sup>129</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e FSHE-së, në DM<sup>130</sup> si dhe në rregulloren e programit të studimit<sup>131</sup>, rezultojnë se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve dhe aktiviteteve të tjera mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Konfirmojmë që, në faqen zyrtare të internetit të USH janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendarin akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të USH, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht<sup>132</sup>.</p>

<sup>127</sup> Evidencë 22-XXII. PLATFORMA ESSE 3; Evidencë 23-XXIII. PLATFORMA PITAGORA.

<https://ushk.pitagora.rash.al/login>

<sup>128</sup> Evidencë 23-XXIII. PLATFORMA PITAGORA. <https://ushk.pitagora.rash.al/login>

<sup>129</sup> Evidencë 20-XX. PLATFORMA MICROSOFT TEAMS.

<sup>130</sup> Evidencë 1.5 Rregullore e FSHE-se; Evidencë 1.28 Rregullore Dep . Mesuesi.

<sup>131</sup> Evidencë 1.6 Rregullore e programit të studimit BA . A.Parashkollor.

<sup>132</sup> <https://unishk.edu.al/>

<b>Konkluzione</b>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit Pitagora, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatojmë, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</p> <p>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në RVB, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili, pasi hartohet nga Administratori, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i mbulimit financiar për programet e studimit dhe njësinë bazë<sup>133</sup>.</p> <p>USH, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, etj<sup>134</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi. Ndërsa plani i financimit të dërguar për këtë program studimi specifikon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, gjithashtu</p>

<sup>133</sup> Evidencë 27-XXVII. KUOTAT E PROJEKT BUXHETIT 2019-2021.

<sup>134</sup> Evidencë 18-XVIII. ANALIZA FINANCIARE 2022.

<p>mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit<sup>135</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Konstatuam që, USH i është nënshtruar një auditimi financiar në Shkurt të vitit 2023, siç parashikon VKM Nr. 83, Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”<sup>136</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konstatojmë se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik dhe konstatojmë se në bilancin e vënë në dispozicion, pasqyrohen të gjitha të dhënat përsa i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera<sup>137</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konstatojmë se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se USH, garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, <i>por nga ana tjetër rënia e numrit të studentëve, vit pas viti, pasqyron vështirësinë për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi</i></p> <p><b>Rekomandojmë që stafi akademik, së bashku me strukturat mbëtetëse të institucionit, të bëjnë përpjekje të aplikojnë në projekte të ndryshme fitimprurëse, në mënyrë që të rrisin qëndrueshmërinë financiare të këtij program studimi.</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>

<sup>135</sup> Evidencë 27-XXVII. KUOTAT E PROJEKT BUXHETIT 2019-2021.

<sup>136</sup> Evidencë 5.6 Njoftim e Raport Auditimi.

<sup>137</sup> Evidencë 18-XXVIII. ANALIZA FINANCIARE 2022.

<sup>137</sup> Evidencë 27-XXVII. KUOTAT E PROJEKT BUXHETIT 2019-2021.

	<p><i>Nga ana tjetër rënia e numrit të studentëve, vit pas viti, pasqyron vështirësinë për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi</i></p> <p><i>Rekomandojmë që stafi akademik, së bashku me strukturat mbëtetëse të institucionit, të bëjnë përpjekje të aplikojnë në projekte të ndryshme fitimprurëse, në mënyrë që të rrisin qëndrueshmërinë financiare të këtij program studimi.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, USH ka hartuar Statutin, Rregulloren e Universitetit <sup>138</sup> , Rregulloren e FSHE-së, Rregulloren e DM-së, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me Rregulloren e studimeve në USH dhe Rregulloren e këtij programit të studimit <sup>139</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë	Konstatojmë që, institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullore së programit të studimit dhe

<sup>138</sup>Evidencë 1-I.STATUTI USH; Evidencë 1.5 Rregullore e FSHE-se; Evidencë 1.28 Rregullore Dep . Mesuesi.

<sup>139</sup> Evidencë 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH; Evidencë 1.6 Rregullore e programit te studimit BA . A.Parashkollor.

<p>kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregulloren e studimeve në USH ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi<sup>140</sup>. Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Rezulton se përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga DM dhe miratim nga Senati Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit "Bachelor Arsim Parashkollor"<sup>141</sup>, duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta<sup>142</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron USH, sipas legjisllacionit në fuqi dhe i publikon ato online. USH, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.</p> <p>Konstatohet që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të USH, sipas fakulteteve përkatëse dhe cikleve të studimit.</p> <p><a href="https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022">https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022</a></p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Rregullorja e ciklit të studimeve në USH, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritet mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet,</li> </ul>

<sup>140</sup> Evidencë 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH; Evidencë 1.6 Rregullore e programit të studimit BA . A.Parashkollor.

<sup>141</sup> Evidencë 2.27 Vendim- Miratim kuota e kriteret pranimit; Evidencë 1.6 Rregullore e programit të studimit BA . A.Parashkollor.

<sup>142</sup> Evidencë 5.1 Komision & Liste fitues troje.

	<p>pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.<sup>143</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Guida e studentëve, ku studenti gjen informacion të plotë mbi fakultet, programet e studimit si dhe stafin akademik<sup>144</sup></li> <li>● Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit<sup>145</sup>.</li> <li>● Kurrikulën e Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor<sup>146</sup></li> <li>● Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin<sup>147</sup>.</li> </ul> <p>Konstatojmë se bazuar në Rregulloren e FSHE-së, në Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e e studimeve ne USH si dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Bachelor Arsim Parashkollor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje</p>	<p>Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi<sup>148</sup>.</p>

<sup>143</sup> Evidencë II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH


<sup>144</sup> Evidencë XIII. GUIDA PER STUDENTET.

<sup>145</sup> Evidencë Syllabuse Arsim parashkollor 1; Evidencë SYLLABUSE Arsim Parashkollor 2.

<sup>146</sup> Evidencë 1.1 Programi i studimit BA. Arsim Parashkollor.

<sup>147</sup> Evidencë 1.6 Rregullore e programit te studimit BA . A.Parashkollor.

<sup>148</sup> Evidencë 2.27 Vendim- Miratim kuota e kritere pranimi.




me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<a href="https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2023-2024">https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2023-2024</a> Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të USH-së, gjenden në çdo kohë plan programet për çdo program studimi: <a href="https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022">https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022</a>		
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kritere dhe kuotat e pranimit për programet e studimit që USH ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. USH, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron <sup>149</sup> .		
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kritere të pranimit për secilin program studimi. ( <a href="https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2023-2024">https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2023-2024</a> ). Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të USH, gjendet në çdo kohë Rregulloret dhe Kriteret për pranimin e studenteve.		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	USH ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë të komunitetit Romë, Ballkano dhe Egjiptianë si dhe jep bursa për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke i publikuar ato në faqen e internetit <sup>150</sup> .		
<b>Konkluzione</b>	<i>Nga vizita në institucion dhe evidancat, konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kritere dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron USH, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online në faqen zyrtare të web-it. Gjithashtu, konstatojmë se USH, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

<sup>149</sup> Evidencë 2.27 Vendim- Miratim kuota e kritere pranimi

<sup>150</sup> Evidencë 5.1 Komision & Liste fitues troje. Evidencë 2.3 Bursat ne USH.

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të USH, sipas fakulteteve përkatëse. (<a href="https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022">https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022</a>) si dhe materiale fizike udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>● Guida e studentëve, ku studenti gjen informacion të plotë mbi fakultet, programet e studimit si dhe stafin akademik<sup>151</sup>.</li><li>● Kurrikulën e Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor<sup>152</sup></li><li>● Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit<sup>153</sup>.</li><li>● Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin<sup>154</sup>.</li><li>● Rregullorja e studimeve në USH, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e</li></ul>

<sup>151</sup> Evidencë XIII. GUIDA PER STUDENTET.

<sup>152</sup> Evidencë 1.1 Programi i studimit BA. Arsim Parashkollor.

<sup>153</sup> Evidencë Syllabuse Arsim parashkollor 1; Evidencë SYLLABUSE Arsim Parashkollor 2.

<sup>154</sup> Evidencë 1.6 Rregullore e programit te studimit BA . A.Parashkollor.



	studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. <sup>155</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin <sup>156</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Konstatojmë se bazuar në Rregulloren e FSHE, në Rregulloren e studimeve në USH dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor <sup>157</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Rregulloren e Programit të Studimit “Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor dhe Rregulloren e studimeve në USH janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi <sup>158</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, u informuam se DM, në fillim të vitit të parë të studimeve nëpërmjet “Ditëve të hapura” informon kandidatët për studentë për strukturën dhe programet e studimit që institucioni ofron. Gjithashtu, gjatë javës së parë të studimeve studentët e rinj prezantohet me stafin akademik të përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës <sup>159</sup> .

<sup>155</sup> Evidencë II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH

<sup>156</sup> Evidencë 1.6 Rregullore e programit të studimit BA . A.Parashkollor.

<sup>157</sup> Evidencë 1.5 Rregullore e FSHE-se; Evidencë 1.6 Rregullore e programit të studimit BA . A.Parashkollor; Evidencë II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH; Evidencë Syllabuse Arsim parashkollor 1; Evidencë SYLLABUSE Arsim Parashkollor 2.

<sup>158</sup> Evidencë 1.6 Rregullore e programit të studimit BA . A.Parashkollor; Evidencë II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH

<sup>159</sup> Evidencë 5.2 Ditët e hapura- Work & Study.

<b>Konkluzione</b>	<i>Nga vizita në institucion dhe evidancat, konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban programi i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Konstatojmë që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Komunikim i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet Platforma ESSE 3 dhe Sistemit PITAGORA. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me format e vlerësimit për secilën lende, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj <sup>160</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin, si dhe nëpërmjet Guidës së Studentit. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e

<sup>160</sup> Evidencë 22-XXII. PLATFORMA ESSE 3; Evidencë 23-XXIII. PLATFORMA PITAGORA.

	<p>mbartura u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të USH<sup>161</sup>.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet lektorë tutor të përcaktuar nga departamenti studentët informohen për kurset, syllabuset, detyrimet, mungësitë që institucioni ofron<sup>162</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se Zyra e Karrierës dhe Alumnit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Zyra e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zgjedhjen e karrierës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon<sup>163</sup>.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti i Mësuesisë në DRAP Lezhë dhe Shkodër, informon studentët mbi mundësitë e punësimit pranë institucioneve arsimore që ofrojnë arsimin parashkollor<sup>164</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, Departamenti i Mësuesisë nëpërmjet lektorëve tutor<sup>165</sup> në bashkëpunim me Njësinë e Karrierës dhe Alumnit, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Në faqen e internetit të USH, gjithashtu gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.</p> <p><a href="https://unishk.edu.al/">https://unishk.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Konstatohet se informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet Sistemit ESSE 3 dhe Pitagora, sikurse pohuan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, arrijnë të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor, platforma të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e procesit mësimor dhe artistik edhe gjatë periudhës së Pandemisë. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen</p>

<sup>161</sup> Evidencë 1.6 Rregullore e programit të studimit BA . A.Parashkollor; Evidencë XIII. GUIDA PER STUDENTET.

<sup>162</sup> Evidencë 2.13 Vendim për miratimin e tutorëve dhe lista e tutorëve.

<sup>163</sup> Evidencë 2.25 Regjistrimi, Diplomimi dhe Punësimi; Evidencë 2.26 Vendim për gjurmimin e studentëve; Evidencë 5.4 Gjurmimi dhe punësimi.

<sup>164</sup> Evidencë 1.9 Plani strategjik FSHE.

<sup>165</sup> Evidencë 2.13 Vendim për miratimin e tutorëve dhe lista e tutorëve.

	online, në rubrikën “UNISHK” dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë <sup>166</sup> .						
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që në faqen e internetit të USH gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e USH dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatit mësimore, bibliotekën, laboratorët</i></p> <p><i>Zyra e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.</i></p> <p><i>Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>			<b>X</b>
<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>					
		<b>X</b>					

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit dhe Plani strategjik për zhvillimin e institucionit, konstatojmë se institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer<sup>167</sup>.</p> <p>Konstatojmë, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për secilin program studimi që USH ofron, specifikisht Programin e Studimit Bachelor Arsim Parashkollor, rezultojnë të regjistruar<sup>168</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për vitin akademik 2019-2020 në total 14 studentë;</li> <li>• për vitin akademik 2020-2021 në total 16 studentë;</li> </ul>

<sup>166</sup> Evidencë 22-XXII. PLATFORMA ESSE 3; Evidencë 23-XXIII. PLATFORMA PITAGORA.

<sup>167</sup> Evidencë 6.1 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE). Evidencë 1.7 Strategjia e programit të studimit BA. A.Parashkollor; Evidencë 1.8 Strategjia e Dep. te Mesuesise; Evidencë 1.9 Plani strategjik FSHE.

<sup>168</sup> Evidencë 4.11 Cilesia ne hyrje e studenteve.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• për vitin akademik 2021-2022 në total 16 studentë.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizita ne institucion, rezulton se Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët. Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatoam se ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi. Keto të dhëna menaxhohen përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve ESSE 3 dhe Pitagora<sup>169</sup>.</p> <p>Gjithashtu, nga vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit (ZKA) konstatoam se ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e tyre. Rezulton se ZKA në bashkëpunim me sektorn mësimor, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit<sup>170</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se sekretaria mësimore e FSHE disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe rregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në sistemin ESSE 3 dhe Pitagora<sup>171</sup>.</p>

<sup>169</sup> Evidencë 22-XXII. PLATFORMA ESSE 3; Evidencë 23-XXIII. PLATFORMA PITAGORA; Evidencë 4.11 Cilesia ne hyrje e studenteve.

<sup>170</sup> Evidencë 2.25 Regjistrimi, Diplomimi dhe Punesimi; Evidencë 2.26 Vendim per gjurmimin e studenteve; Evidencë 5.4 Gjurmimi dhe punesimi.

<sup>171</sup> Evidencë 2.25 Regjistrimi, Diplomimi dhe Punesimi

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Rezultoni se institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse, për vlerësim, dokumentimin dhe saktësimin e informacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe Zyres së Karrierës dhe Alumni<sup>172</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjuesve.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë<sup>173</sup>. Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje<sup>174</sup>, por:</p> <p><i>Institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi, por institucioni nuk ka paraqitur një raport analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.5**

<sup>172</sup> Evidencë 5.6 Njoftim e Raport Auditimi; Evidencë 2.25 Regjistrimi, Diplomimi dhe Punesimi; Evidencë 3.11 Raportim Clean Score mbi provimet ne FSHE.

<sup>173</sup> Evidencë 17-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE 2022. Evidencë 1.27 Analiza e Punes mesimore-shkencore Dep .Mesuesise.

<sup>174</sup> Evidencë XLII. RAPORT NGA ZYRA E KËSHILLIMIT TË KARRIERËS DHE ALUMNIT; Evidencë 4.11 Cilesia ne hyrje e studenteve, Evidencë 2.25 Regjistrimi, Diplomimi dhe Punesimi

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Konstatohet që studentët e USH janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në bordin Administrativ<sup>175</sup>, në Grupet e vlerësimit të brendshëm si dhe në NJSBC për vlerësimin e cilësisë së FSHE ngritur në vitin 2023 në rang institucional.</p> <p>Rezulton se në prill të vitit 2022 u zhvilluan zgjedhjet për këshillat studentor në rang njësie kryesore dhe atë institucional<sup>176</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Rezulton që institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatin Akademik, në grupin e ngritur nga NJSBC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë<sup>177</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga vizita në institucion, përgjatë takimit me studentët, konstatojmë se ata janë të përfshirë në mënyrë indirekte, nëpërmjet realizimit të pyetësorëve për procesin mësimor dhe vlerësimit të lektorëve në përmirësimin e cilësisë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësive bazë për akreditimin dhe janë pjesë e GVB, për hartimin e RVB për Programin e Studimit Bachelor Arsim Parashkollor<sup>178</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësive/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e pyetësorit të studentëve, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.</p> <p>Konstatohet që NJSBC zhvillon pyetësorë në mënyrë periodike dhe disponon instrumenteve matës që përdorin për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët<sup>179</sup>.</p>

<sup>175</sup> Evidencë L. VENDIM PËR ANËTARESIMIN NË BORD TË PERFAQËSUESIT TË STUDENTËVE.

<sup>176</sup> Evidencë 2.28 Studente fitues ne keshillat studentore; Evidencë XXXII. RREGULLORE E ZGJEDHJEVE STUDENTOR; Evidencë XXXIII. RREGULLORE E KESHILLAVE STUDENT.

<sup>177</sup> Evidencë B vendimi i formimit te GVB-se; Evidencë 2.28 Studente fitues ne keshillat studentore.

<sup>178</sup> Evidencë B vendimi i formimit te GVB-se

<sup>179</sup> Evidencë 2.22 feedback pyetesori nga Zyra e Sigurimit te Cilesise; Evidencë 2.23 Feedback pyetesori NJSBC.

<b>Konkluzione</b>	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që studentët e USH janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të insitucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm dhe u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës</i> <i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Konstatojmë se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet Platformave si ESSE 3, Pitagora, SMAK e LMS <sup>180</sup> . DM në bashkëpunim me zyrën e Karrierës vë në dispozicion të tyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do të ndjekin.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Konstatojmë që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të USH dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohet nëpërmjet aksesit në sistemin Pitagora.  <a href="https://ushk.pitagora.rash.al/login">https://ushk.pitagora.rash.al/login</a>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në	Konstatojmë se nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe tutorëve përcaktuar nga departamenti <sup>181</sup> , kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për

<sup>180</sup> Evidencë 22-XXII. PLATFORMA ESSE 3; Evidencë 23-XXIII. PLATFORMA PITAGORA; Evidencë 24-XXIV. PLATFORMA SMAK; Evidencë 20-XX. PLATFFORMA MICROSOFT TEAMS.

<sup>181</sup> Evidencë 2.13 Vendim për miratimin e tutorëve dhe lista e tutorëve.



<p>mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon. Gjithashtu ky sektor ofron informacion për bursa, informacion në lidhje me mobilitetet dhe programet e shkëmbimeve jashtë vendit si dhe në bashkërendim me DM orienton studentët për zhvillimin e praktikës profesionale<sup>182</sup>.</p>
---	---

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Konstatohet që Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni po punon për ka nisur procesin e e gjurmimit të studentëve pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit<sup>183</sup>.</p> <p>Gjithashtu departamenti, nëpërmjet koordinorit të programit, mban lidhje dhe gjurmon studentët pas diplomimit të tyre.</p>
---	--

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon</i></p> <p><i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>
---------------------------	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<sup>182</sup> Evidencë 1.40 Analize e Praktikës profesionale.

<sup>183</sup> Evidencë 2.26 Vendim për gjurmimin e studenteve; Evidencë 2.25 Regjistrimi, Diplomimi dhe Punesimi.



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Universiteti i Shkodrës, ka hartuar Strategjinë e Mësimdhënies<sup>184</sup> ku jepen direktiva të qarta për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ato orientojnë për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e syllabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj.</p> <p>Gjithashtu departamenti dhe Drejtoria e Kurrikulës monitorojnë dhe rishikojnë programet e studimit si dhe syllabuset e kurseve që ofrohen në programet e studimit që DM ofron<sup>185</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatuam se institucioni ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH, bazuar në Statutin e USH, Neni 18<sup>186</sup>.</p> <p>Rezulton se institucioni ka hartuar Paketën e Instrumenteve për Matjen e Cilësisë në USH<sup>187</sup>, e cila përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësor për lëndën/modulin;</li> <li>- Të dhëna mbi veprimtarinë e pedagogut;</li> <li>- Raporti i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu;</li> <li>- Pyetësor lidhur me programin e studimit;</li> <li>- Pyetësor për studentët e diplomua në USH;</li> <li>- Pyetësor për punëdhënësit;</li> <li>- Formular vlerësimi nga personeli akademik.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Rezulton se në USH, Zyra e Njësimit të Brendshëm dhe Vlerësimit të Cilësisë është përgjegjëse për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies,</p>

<sup>184</sup> Evidencë IV. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES 2022.

<sup>185</sup> Evidencë 2.17 Vendim-Miratim syllabusesh.

<sup>186</sup> Evidencë XV. VENDIM- RREGULLORE E SA PER KSGC.

<sup>187</sup> Evidencë XVI. PAKETA E INSTRUMENTAVE MATËS TË CILËSISË NË USH.

	<p>vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre<sup>188</sup>.</p> <p>Ajo organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët dhe i bën të ditur për stafin akademik rezultatet që dalin pas përpunimit. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të USH-së. Analiza e pyetësorit diskutohet në departament, ku çdo pedagog ka të drejtën të njihet me vlerësimin që iu bëhet nga studentët<sup>189</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Zyra e Njësimit të Brendshëm dhe Vlerësimit të Cilësisë është përgjegjëse për realizimin e pyetësorëve të studentëve, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, qoftë në rrugë konfidenciale, qoftë në rrugë publike<sup>190</sup>.</p> <p>Nga ana tjetër, rezulton se, Analiza e Raportit të Brendshëm të Cilësisë diskutohet në departament për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.<sup>191</sup></p> <p>Gjithashtu, një strukturë tjetër e ngritur pranë USH-së për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie është Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH<sup>192</sup>, i cili nëpërmjet hartimit të Paketës së Instrumenteve për Matjen e Cilësisë<sup>193</sup>, nxit procesin e sigurimit të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Rezulton se, institucioni nëpërmjet Analizës Vjetore dhe asaj kërkimore-shkencore të DM<sup>194</sup>, nxit departamentet të hartojë plan veprimin për marrjen e masave për përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu, feedbacku marrë nga pyetësorët e studentëve, diskutuar në departament shërben si një strategji për përmirësimin e cilësisë referuar sugjerimeve të studentëve<sup>195</sup>.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH dhe se Zyra e Njësimit të Brendshëm dhe Vlerësimit të Cilësisë organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>

<sup>188</sup> Evidencë 2.22 feedback pyetesori nga Zyra e Sigurimit te Cilesise; Evidencë 2.23 Feedback pyetesori NJSBC.

<sup>189</sup> Evidencë 2.18 Mbledhje Departamenti mbi Relacionin e Pyetesorit nga Zyra e Sigurimit te cilesise

<sup>190</sup> Evidencë X. MANUALI I CILËSISË.

<sup>191</sup> Evidencë 6.1 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE).

<sup>192</sup> Evidencë XV. VENDIM- RREGULLORE E SA PER KSGC.

<sup>193</sup> Evidencë XVI. PAKETA E INSTRUMENTAVE MATËS TË CILËSISË NË USH.

<sup>194</sup> Evidencë 1.27 Analiza e Punes mesimore- shkencore Dep .Mesuesise.

<sup>195</sup> Evidencë 2.22 feedback pyetesori nga Zyra e Sigurimit te Cilesise; Evidencë 2.23 Feedback pyetesori NJSBC.

	<i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se institucioni ka hartuar politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në USH bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë si dhe në Statutin e USH-së, Neni 24<sup>196</sup>.</p> <p>Rezulton se, institucioni ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë<sup>197</sup> dhe aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Zyrës e Njësimi të Brendshëm dhe Vlerësimit të Cilësisë.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Konstatojmë që, institucioni ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë<sup>198</sup> dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet Manualit të Cilësisë, që USH ka hartuar përcaktohen qartë strukturat kryesore përgjegjëse për zbatimin e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë<sup>199</sup>.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si	<p>Konstatojmë që, institucioni nëpërmjet Paketës se Instrumenteve për Matjen e Cilësisë në USH përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë siç janë pyetësor për lëndën/modulin; pyetësor lidhur me programin e studimit; pyetësor për studentët e diplomua në USH;</p>

<sup>196</sup> Evidencë 1-I.STATUTI USH.

<sup>197</sup> Evidencë XV. VENDIM- RREGULLORE E SA PER KSGC.

<sup>198</sup> Evidencë XV. VENDIM- RREGULLORE E SA PER KSGC.

<sup>199</sup> Evidencë X. MANUALI I CILËSISË.

dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	pyetësor për punëdhënësit; raporti i vetëvlerësimit të lendës nga pedagogu dhe formular vlerësimi nga personeli akademik <sup>200</sup> .  Gjithashtu rezultoi se, institucioni realizoi përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni hartoi <sup>201</sup> .		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Konstatohet që, institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes si dhe arritjeve përmes sondazheve dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën mësimore-shkencore të stafit akademik.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</i>  <i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e	Rezultoi se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që FSHE dhe DM ofron, <sup>202</sup> metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe

<sup>200</sup> Evidencë XVI. PAKETA E INSTRUMENTAVE MATËS TË CILËSISË NË USH.

<sup>201</sup> Evidencë 6.1 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE).

<sup>202</sup> Evidencë 6.1 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE).

<p>praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>format e vlerësimit, veprimtaritë kërkimore shkencore duke analizuar faktorët e riskut për çdo kategori<sup>203</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit të Zhvillimit të USH, Raporti vjetor i punës mësimore-shkencore i stafit akademik të DM-së, si dhe Raportit të brendshëm të vlerësimit, rezultojnë se institucioni ka përfshirë analizën SWOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë<sup>204</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Rezultojnë se institucioni në kuadër të vlerësimit të mbarëvajtjes të cilësisë së programit të studimit ka hartuar Strategjinë e Mësimdhënies dhe Manualin e Cilësisë që garantojnë monitorimin dhe zhvillimin e cilësisë së programeve të studimit<sup>205</sup>.</p> <p>Nga ana tjetër, nëpërmjet Paketës së Instrumenteve për Matjen e Cilësisë në USH<sup>206</sup> ka hartuar metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e mësimdhënies, e metodave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve si dhe kurrikulës nëpërmjet instrumenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësor për lëndën/modulin;</li> <li>- Pyetësor lidhur me programin e studimit;</li> <li>- Pyetësor për studentët e diplomuar në USH;</li> <li>- Pyetësor për punëdhënësit.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët<sup>207</sup>;</li> </ul>

<sup>203</sup> Evidencë 1.27 Analiza e Punes mesimore- shkencore Dep .Mesuesise.

<sup>204</sup> Evidencë VIII.STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022; Evidencë 1.27 Analiza e Punes mesimore- shkencore Dep .Mesuesise; Evidencë 6.1 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE).

<sup>205</sup> Evidencë IV. STRATEGJIA E MËSIMDHENIES 2022; Evidencë X. MANUALI I CILËSISË.

<sup>206</sup> Evidencë XVI. PAKETA E INSTRUMENTAVE MATËS TË CILËSISË NË USH.

<sup>207</sup> Evidencë 2.22 feedback pyetesori nga Zyra e Sigurimit te Cilesise.

<p>administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Fokus grupet për vlerësimin e mësimdhënies<sup>208</sup>;</li> <li>● Raportin e Vlerësimit të Programit të Studimit<sup>209</sup>;</li> <li>● Raportin vjetor të punës mësimore-shkencore i stafit akademik të DM<sup>210</sup>;</li> <li>● Statistikat për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik DM<sup>211</sup>.</li> </ul>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="563 824 746 898">Përmbushet</th> <th data-bbox="754 824 981 898">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="989 824 1204 898">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1212 824 1452 898">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="563 904 746 929"></td> <td data-bbox="754 904 981 929"></td> <td data-bbox="989 904 1204 929"></td> <td data-bbox="1212 904 1452 929" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rezulton që, nëpërmjet analizës SWOT të Strategjisë së Zhvillimit të USH-së si dhe Raportit vjetor të punës amësimore-shkencore të stafit akademik të DM, institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit<sup>212</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të</p>	<p>Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për</p>

<sup>208</sup> Evidencë 6.3 Model feedback pyetesori per lenden ne fund semester.

<sup>209</sup> Evidencë RVB Arsim Parashkollor

<sup>210</sup> Evidencë 1.27 Analiza e Punes mesimore- shkencore Dep .Mesuesise.

<sup>211</sup> Evidencë 1.13 Cilesia e stafit; Evidencë 1.14 Kualifikimi i stafit.

<sup>212</sup> Evidencë VIII.STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022; Evidencë 1.27 Analiza e Punes mesimore- shkencore Dep .Mesuesise.

studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave <sup>213</sup> .		
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në Rregulloren e Studimeve në USH <sup>214</sup> .		
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në Statutin e USH-së, në Rregulloren e Studimeve, në kutatat e përcaktuara për studentët, në përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale dhe në grupet e vlerësimit, rezulton se, institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve <sup>215</sup> .		
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me institucionet arsimore për realizimin e praktikave profesionale, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus + luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij program studimi <sup>216</sup> .		
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>  <i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>N</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<sup>213</sup> Evidencë B vendimi i formimit të GVB-se.

<sup>214</sup> Evidencë II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH.

<sup>215</sup> Evidencë I-I.STATUTI USH; Evidencë II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH; Evidencë B vendimi i formimit të GVB-se.

<sup>216</sup> Evidencë 1.2 Lista e marreveshjeve institucionale; Evidencë 1.3 Marreveshja me DRAP, Lezhe; Evidencë 1.4 Marreveshja me KSSH.



**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Rezultoni se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të USH<sup>217</sup>.</p> <p>Gjithashtu, në shërbim të rritjes së cilësisë USH ka hartuar Strategjinë e Mësimdhënies 2022-2026. Nga ana tjetër, DM harton çdo akademik analizën SWOT të punës kërkimore-shkencore të departamentit<sup>218</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Planin Strategjik të FSHE-së, të DM-së, të programit të studimit, Rregulloren në rang njësie baze, Rregullren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale<sup>219</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Konstatojmë se, në Planin Strategjik të Mësimdhënies dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor është hartuar analiza për sigurimin e cilësisë e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara<sup>220</sup>.</p> <p>Rezultoni, gjithashtu, se në Planin Strategjik të FSHE-së, të DM-së, të programit të studimit si dhe në analizën vjetore mësimore shkencore paraqitet një plan masash për përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara<sup>221</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në</p>	<p>Konstatojmë se, institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të</p>

<sup>217</sup> Evidencë IV. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES 2022.

<sup>218</sup> Evidencë 1.27 Analiza e Punës mesimore- shkencore Dep .Mesuesise.

<sup>219</sup> Evidencë 1.5 Rregullore e FSHE-se; Evidencë 1.9 Plani strategjik FSHE Evidencë 1.8 Strategjia e Dep. te Mesuesise; Evidencë 1.6 Rregullore e programit te studimit BA . A.Parashkollor; Evidencë 1.7 Strategjia e programit te studimit BA. A.Parashkollor.

<sup>220</sup> Evidencë V. STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR 2022; Evidencë IV. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES 2022.

<sup>221</sup> Evidencë 1.27 Analiza e Punës mesimore- shkencore Dep .Mesuesise. Evidencë 1.9 Plani strategjik FSHE Evidencë 1.8 Strategjia e Dep. te Mesuesise; Evidencë 1.7 Strategjia e programit te studimit BA. A.Parashkollor.

përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	cilësisë, mbështetur në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm dhe analizën e tyre në department <sup>222</sup> .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i RVB-së dhe diskutimet e realizuara nga takimi me Zyrën e Kurrikulës, rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti <sup>223</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregulloren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>Përmbyhet kryesisht</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>Përmbyhet kryesisht</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>X</b>
--	-----------------------------	----------------------------	-----------------------------	----------

<sup>222</sup> Evidencë 6.1 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE).

<sup>223</sup> Evidencë 6.1 Analiza e RVB (Departament Mesuesi & FSHE).

### **Pika të forta**

1. Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor ka një përvojë 27-vjeçare që zbatohet dhe ai tashmë është i konsoliduar dhe i efektshëm në formimin e mësuesve të arsimit parashkollor.
2. Programi i studimit mbulohet nga një staf akademik i kualifikuar dhe cilësor për zbatimin e tij.
3. Programi i studimit, i zbatuar, përmbush të gjitha kriteret ligjore në fuqi.
4. Kurrikula e programit përditësohet vazhdimisht në përshtatje me ndryshimet kurrikulare në arsimin parashkollor konform Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parashkollor
5. Staf i akademik i programit është i përfshirë në projekte dhe veprimtari shkencore dhe në mësimdhënie në universitetet e vendeve të rajonit dhe më gjerë.
6. Njësia bazë zbaton marrëveshje institucionale me kopshte të arsimit parashkollor, ku zhvillohen praktika të efektshme profesionale me studentët.

### **Pika të dobta**

1. Ulje e numrit të studentëve në këtë program dhe mungesë e informacionit të detajuar mbi punësimin e tyre.
2. Mungesa e zbatimit të një strategjie marketingu për programin, më synim rritjen e numrit të studentëve.
3. Nevoja për të patur një Udhëzues institucional lidhur me Metodologjitë e mësimdhënies dhe të të nxëniet të të rriturve.
4. Rënia e numrit të studentëve, vit pas viti, pasqyron vështirësinë për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi

### **Rekomandime**

1. Hartimi dhe zbatimi i një strategjie marketingu për rritjen e numrit të studentëve në këtë program.
2. Hartimi i një udhëzuesi institucional për metodologjitë e mësimdhënies dhe të të nxëniet me të rriturit.
3. Rekomandohet që stafi akademik, së bashku me strukturat mbëtetëse të institucionit, të bëjnë përpjekje të aplikojnë në projekte të ndryshme fitimprurëse, në mënyrë që të rrisin qëndrueshmërinë financiare të këtij program studimi.



### **Strong points**

1. The Bachelor of preschool education teacher study program has a 27-year experience of being implemented and it is already consolidated and effective in the training of preschool teachers.
2. The study program is covered by a qualified and quality academic staff for its implementation.
3. The study program, implemented, fulfills all legal criteria in force.
4. The curriculum of the program is constantly updated in accordance with the curricular changes in preschool education in accordance with the Curriculum Framework of Preschool Education in Albania.
5. The academic staff of the program is involved in scientific projects and activities and in teaching in the universities of the countries of the region and beyond.
6. The basic unit implements institutional agreements with kindergartens of preschool education, where effective professional practices are developed with students.

### **Weakness**

1. Decrease in the number of students in this program and lack of detailed information on their employment.
2. Lack of implementation of a marketing strategy for the program, we aimed to increase the number of students.
3. The need to have an institutional Guide regarding the Teaching and Learning Methodologies of adults.
4. The decrease in the number of students, year after year, reflects the difficulty in generating the necessary income in the future for this study program

### **Recommendations**

1. Development a marketing strategy for increasing the number of students in this program.
2. Development of an institutional guide for teaching and learning methodologies with adults.
3. It is recommended that the academic staff, together with the remaining structures of the institution, make efforts to apply to various profitable projects, in order to increase the financial sustainability of this study program.



Fushat e vleresimit	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X